

KTHIM NË PASIGURI
TE ZHVENDOSURIT E BRENDSEHM
TE KOSOVES DHE PROCESI I KTHIMIT

13 Dhjetor 2002



TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME.....	i
I. HYRJE: KUSH JANE TE ZHVENDOSURIT?	1
II. HIJA E STATUSIT FINAL	3
III. PARIMET NDERKOMBETARE TE KTHIMIT	4
IV. PERPJEKJET FILLESTARE TE KTHIMIT TE TE ZHVENDOSURVE.....	5
A. POLITIKA E KTHIMIT TE HERSHEM	5
B. PROGRESI I HERSHEM I KTHIMIT	6
V. STUDIMET E RASTEVE: DY REGJIONE TE NDRYSHME	7
A. PEJE: KTHIMI I ORGANIZUAR NE NJE RAJON TE VESHTIRE.....	8
1. Fusha Osojanit: Krijimi i nje Enklave te re Serbe	9
2. Kthimi i Serbëve në Klinë	11
3. Kthimi i Planifikuar i Serbëve në Pejë	12
4. Bashkëjetesa ndërmjet komuniteteve	13
5. Bashkësitë e lëna pas dore	14
B. GJILAN: KTHIMET E QËNDRUESHME.....	14
1. Normalizimi i gjendjes më të madhe së Sigurisë.....	15
2. Klima Politike e Kthimit	16
3. Procesi i Kthimit	16
4. Komunitetet e Anashkaluara	17
C. KRAHASIMI I DY RAJONEVE.....	17
1. Parimet Ndërkombëtare të Kthimit	18
2. Siguria Logjike	18
3. Parakushtet: Dialogu dhe Ekonomia	18
4. Bashkëpunimi: Koordinimi	19
5. Mbështetja politike pa Politizim.....	19
6. Sfidat e vazhdueshme në të Dy Rajone	19
VI. KUSHTET GJENERALE PËR KTHIMIN NË TËRË KOSOVËN.....	20
A. SIGURIA, SIGURIMI DHE LIRIA E LËVIZJES	20
B. STREHIMI	22
C. EKONOMIA	23
D. SHËRBIMET PUBLIKE	24
E. PRANIMI NGA ANA E KOMUNITETIT SHUMICË.....	25
VII. MUNDËSIMI I KTHIMIT: POLICIA DHE LOJTARËT NË POCESIN E KTHIMIT	26
A. VEPRUESIT KRYESORË DHE QËNDRIMET E TYRE	27
1. UNMIK: Zyra për Kthime dhe Komunitete (ORC)	27
2. UNHCR	28
3. KFOR.....	29

4.	Policia	29
5.	Qendra për Koordinim për Kosovë dhe Metohi (CCK):	29
6.	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (PISG)	30
7.	Partitë Politike Shqiptare	31
8.	Partitë Politike Serbe në Kosovë	31
B.	STRATEGJIA E UNMIK-UT PËR KTHIM	31
1.	Strukturat Koordinuese dhe Finansimi	31
2.	Mbështetja e Strategjisë: Qëshhtjet e Mbetura.....	32
VIII. KONKLUZION.....		34
A.	TEJKALIMI I SFIDAVE TË KTHIMIT	34
APPENDIKSET		
A.	HARTA E KOSOVËS	36
B.	FJALOR I SHKURTESAVE.....	37
C.	GRUPI NDËRKOMBËTAR I KRIZAVE.....	38
Ç.	RAPORTI I GNK-SË DHE DOKUMENTE INFORMATIVE.....	39
E.	ANËTARËT E KËSHILLIT TË GNK-SË.....	44



KTHIM NË PASIGURI TË ZHVENDOSURIT E BRENDSHËM TË KOSOVËS DHE PROCESI I KTHIMIT PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

E drejta e të zhvendosurve të brendshëm dhe refugjatëve të kthehen në vatrat e tyre në Kosovë është e pakontestueshme, dhe është bërë çështje me prioritet për bashkësinë ndërkombetare dhe UNMIK-un.

Nëse kryhet si duhet, kthimi do të mund të përmirësonte marrëdhëniet ndërmjet grupeve etnike, do të forconte pozitën e bashkësive minoritare që vec jetojnë në rajon, dhe do të kontribonte në pajtimin gradual në mes bashkësive që kanë qenë në konflikt. Mirëpo nëse kthimi politizohet së tepërmi dhe nuk menaxhohet si duhet, atëherë mund ta rrezikojë edhe më keq ekzistencën e dobët të minoriteteve. Shkurt, mënyra e planifikimit dhe implementimit është kritike për qëndrueshmërinë afatgjatë të procesit.

Të dhenat e bashkësisë ndërkombëtare mbi procesin e kthimit janë të përziera. Nga më shumë se 230 000 të zhvendosur, vetëm 5800 janë kthyer. Edhe pse kanë kaluar vetëm tri vite nga përfundimi i luftës, Kosova paraqet një ambient tepër sfidues për kthim. Liria e lëvizjes, shfrytëzimi i shtëpive dhe tokave, mundësia e punësimit, ekzistimi i shërbimeve publike për minoritete, dhe qëndrimet e bashkësisë që i pranon janë të gjitha pengesa.

Per t'iu pergjigjur ketyre sfidave, Zyra e UNMIK-ut per Kthimin e Bashkesive (ORC) ka zhvilluar nje strategji te re dhe ka ristrukturuar menyren e kordinimit te projekteve. Edhepse strategjia nuke eshte implementuar plotesisht, eshte nje hap ne

drejtimin e duhur. Tanime ORC ka sigurur se i largohet burokratizimit te procesit te kthimit dhe se ruan nje mardhenie te bashkepunimit te ngushte me partnret kryesore - Komisionerin e Larte te Kombve te Bashkuara per Refugjate (UNHCR) dhe KFOR-in, si dhe merret me menaxhimin e dimensioneve te koklavitura politike te shkaktuara nga hija e statusit final.

Natyra e pazgjidhur e statusit final te Kosoves ndikon ne kthimin ne dy drejtime. Se pari e politizon ceshtjen e kthimit te serbeve. Per bashkesine nderkombetare kthimi i serbeve ne vatrat e tyre do te siguronte se intervenimi i NATO-s i vitit 1999 dhe prezenca e mepastajme nderkombetare nuk kane cuar drejt krijimit te Kosoves nje-etnike. Per me teper, do te ndihmonte qe te bindej Keshilli i Sigurimit se kushtet jane pjekur per diskutimin e statusit final. Nderkohe qeveria serbe kerkon kthimin e serbeve per qellimet e veta - ndarjen apo kantonizimin e Kosoves.

Se dyti, fokusi i bashkesise nderkombetare eshte koncentruar kryesisht ne numrin e personav qe kthehen, e jo ne sigurimin qe procesi te kryhet sipas prarimeve nderkombetare. Kjo do te thote qe kthimi te jete vullnetarisht; ne siguri te plote dhe dinjitet; mbrojtje; dhe ne mbikqyrje nga rreziqet.

Disa incidente - edhepse te rralla - po perkujtojne se te kthyerit nuk jane te mireseardhur. Ne korrik te 2002, nje poster trishtues i vrasjes se nje femiu shqiptar (mendohet te jete vrare nga nje serb) eshte

paraqitur ne rruget e qyteteve kryesore te Kosoves me mbishkrimin "Mos i lejoni kriminet te kthehen". Ne tetor, te kthyerit serb arriten ne Peje me autobus per regjistrim pensional. Kjo pat shkaktuar nje proteste qe pat eskaluar ne hudhje te gureve dhe bomba benzine. Perderisa udheheqsit shqiptare pergjithesisht i kane denuar aktet e tilla, veprimtaria e tyre per te mbeshtetur kthimin nuk ka qene me shume se retorike. Edhe pse kryeministri Rexhepi i ka mbeshtetur komunitetet minoritare, kryetari Rugova nuk ka thene gje dhe ka mbetur joaktiv. Duke marrur parasysh predominancen e partise se LDK-se ne strukturat komunale, roli i tij gjithsesi eshte i domosdoshem.

Nje numer i madh faktoresh - c'prej agjensive nderkombetare si dhe organizatave joqeveritare - jane te kycur ne procesin e kthimit. Ky raport skicon divergjencen ekstreme te politikave dhe metodave te kthimit ne dy rajone - rajonin e Pejës dhe te Gjilanit. Edhe pse ato jane te ndryshme, nje krahasim i procesit te kthimit jep mesime qe jane te aplikueshme neper tërë Kosovën.

Perderisa qe te dy vendet kane pare nje numer relativisht te barabarte te te kthyerve, kushtet nuk jane aq te pershtatshme ne Peje. Ne projektet e deritanishme, bashkesia nderkombetare eshte kujdesur me shume per numrin sesa per pergaditjen e kushteve te kthimit. Fshatrat nuk kane pasur mundesi shfrytezimi te sherbimeve esenciale, nuk ka pasur kurrefar dialogu me bashkesine qe i ka pranuar, dhe sigurimi i te ardhurave dhe sherbimet publike nuk jane siguruar deri pas arrijtes se te kthyerve. Ne Gjilan, dialogu me bashkesine qe i ka pranuar, mbeshtetja e aktiviteteve per sigurimin e te ardhurave, dhe mundesia e shfrytezimit te sherbimeve publike jane trajtuar si pjese e planit te pergjithshem te kthimit. Menyra e kthimi ka rendesi te madhe per mardheniet midis bashkesive, kushtet qe te kthyerit i perjetojne, dhe per qendrueshmerine e pergjithshme te procesit.

Krahasimi i ketyre dy vendbanimeve tregon se kthimi i qendrueshem kerkon nje vemendje te posaqme ndaj aplikimit te parimeve nderkombetare, sigurimit të logjikshem, mekanizmave te forte koordinues, dhe mbshtetjes se bashkesiseqe i pranon ata. Sukses i rrethit te Gjilanit gjithashtu tregon se kthimi ne kushte te sigurise dhe dinjitetit

eshte i mundshem ne Kosove mu tani - por duhet nje planifiim dhe paramendim i kujdesshem.

Suksesi i vonuar i procesit te kthimit ne Bosnje tregon se progresi nuk eshte i domosdoshem te jete linear, dhe se duhet te kaloje nje kohe para se te ndodhin perparime te rendesishme. Bashkesia nderkombetare duhet te jete reale lidhur me parashikimet e saja ne Kosove. Edhe pse nuk eshte e qarte se sa persona te zhvendosur do te kthehen, eshte shume e papritur qe nje numer i madh i te zhvendosurve do te kthehet ne te ardhmen e afert. Sidoqë te jete, te gjithë duhet ta kene rastin ta ushtrojne te drejten e kthimit ne siguri dhe dinjitet.

REKOMANDIME

Bashkësisë ndërkombëtare:

1. Te vendoset si prioritet kryesor qe parimet nderkombetare qe udheheqin kthimin e te zhvendosurve te aplikohen ne Kosove e jo te fokusohet ne numrin e te kthyerve.
2. Te ofroje mbeshtetje financiare per te kthyerit, duke perfshire sigurimin qe rajonet minoritare te kene pjesen e resurseve, dhe te mbeshtetin OJQ-te dhe projektet lidhur me dialogun dhe segmentet per sigurimin e te ardhurave.
3. Te permiresohen kushtet per kthim nepermjet krijimit te strukturave nxitese, si per shembull preferenca per kompani multietnike.
4. Te japi burime te mjaftueshme donacionesh ne fillim te vitit ne menyre qe nerezit te kene mundesi kthimi, te rindertojne shtepite e tyre, dhe te arrijne nje nivel te mjaftueshem te vetembajtjes para fillimit te dimrit.

Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë:

5. Te siguroje qe plani i Ristrukturimit te Zyres se Kthimit te Minoiteteve mbeshtetet nga niveli komunal dhe regjional i UNMIK-ut.
6. Te siguroje qe Strategjia e Sigurimit Tranzicional dhe transferimi i pergjegjesive nga KFOR-i ne policine e UNMIK-ut nuk i le bashkesite e te kthyerve te rrezikuar.
7. Te ofroje nxitje konkrete, si beneficione financiare per komunat, qe te rrisin ndihmen per rindertim per bashkesite minoritare.

8. Ta dokumentoje dhe te ndermarre masa te ashpra - duke perfshirre edhe perjashtimin nga puna - kunder zyrtareve qe e pengojne kthimin.
9. Ti kushtoje me shume rendesi kerkesave prane Drejtorise se Banimit dhe Prones.

Zyres së Kthimit dhe Bashkësive (ORC):

10. Te krijoje nje model rajonal per kthim ne Gjilan, ku donatoret, OJQ-te, dheagjensite tjera implmentuese mund te marrin pervojte dhe mesime.
11. Te siguroje qe asistenca per kthim bazohet ne nevoje, e jo kombesi, dhe te permiresohet padrejtësia qe iu eshte bere romeve, hashkalinjeve, egjyptianeve dhe boshnjakeve te zhvendosur.
12. Te zhvilloje nje fushate informimi si pjese e Strategjise se Kthimit ne menyre qe te sigurohet se informatat qe arrijene tek te zhvendosurit jane te sakta dhe te qarta.
13. Te perfshije ne Strategjine e kthimit iniciativa per vazhdimin e punes me personat qe jane kthyer per ti inkurajuar qe te qendrojne me tutje.
14. Ta rrise personelin e ORC-se ne Serbi dhe Mal te Zi dhe te perdore zyren lidhese te KB-se ne Shkup qe te sigurohet se mesazhi i ORC-se i arrine te zhvendosurit dhe bashkesite e refugjateve dhe se ORC-ja eshte ne gjendje te koordinoje procesin e kthimit.
15. T'i zgjeroje perpjekjet per informimin e te kthyerve per mundesite e punesimit ne sektorin publik, te caktuara per ta ne ligjin e vendosur nga sherbimi civil.
16. Te mbikqyre procesin ekstenziv te rishikimit te projekteve te kthimit dhe te shqyrtoje reduktimin e shkalleve te rishqyrtimit qe propozimi duhet ti kaloje nese procesi merr shume kohe.

UNHCR-s:

17. Te ofroje udhezim per donatoret duke dokumentuar dhe treguar publikisht brengat lidhur me procesin e kthimit.
18. Te rrise perpjekjet e mbeshtetjes ne emer te minoriteteve joserbe.

Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes:

19. Te siguroje qe ofertat e sherbimit publik jane te barabarta, dhe se te drejta te barabarta dhe mundesi shfrytezimi te fondeve komunale dhe qeveritare dhe mundesi punesimi kane te gjitha bashkesite.
20. Te ndjekin shembullin e Kryeministrit Rexhepi dhe te angazhohen ne aktivitete - si vizitimin e rajoneve te te kthyerve - qe tregon nje perkushtim ndaj procesit te kthimit.
21. T'i perjashtoje zyrtaret qe pengojne kthimin.

Beogradit:

22. T'i kordinoje perpjekjet me zyren e UNMIK-ut per Kthimin e Bashkesive, dhe te siguroje qe cdo ndihmese e dhene nga Qendra per Kordinim e Kosoves nuk i keqëson ndasitë ne mes bashkesive.
23. Ta rrise te drejten e levizjes se te kthyerve dhe te tjerve duke i pranuar tabelat e reja te liqences se Kosoves.

Partive Politike Serbe

24. T'i perdorin sherbimet publike te UNMIK-ut dhe te perpiqen te punojne me bashkesine shumice.

Prishtinë/Bruksel, 13 dhjetor 2002

KTHIM NË PASIGURI TË ZHVENDOSURIT E BRENDSHËM TË KOSOVËS DHE PROCESI I KTHIMIT

I. HYRJE: KUSH JANE TE ZHVENDOSURIT?

Perderisa arritja e UNMIK-ut dhe KFOR-it ua ka mundesuar 850,000 shqiptareve te zhvendosur gjate luftes se viteve 1998 dhe 1999 te kthehen ne shtëpите e tyre¹, nuk ka mundur ta parandaloje nje vale tjetër te zhvendosjes. Nje numer i madh i bashkesive minoritare ka ikur se bashku me forcat jugosllave dhe serbe, duke iu friguar sulmeve hakmarrese. Te tjeret kane ikur me vone, pasiqe ishte bere e qarte se

sigurimi nderkombetar dhe prezenca civile nuk mjaftonte per mbrojtjen e tyre, shtepive dhe prones se tyre.

Numri i sakte i ketyre te zhvendosurve eshte veshtire te percaktohet. Asnje regjistrim i sakte nuk eshte bere pas largimit te tyre nga Kosova dhe shume prej tyre nuk jane regjistruar ne asnje agjensi nderkombetare ose ne qeverine qe i ka pranuar. Vleresimet thone se jane midis 230 000 dhe 280 000 qe bien ne tri kategori:

- Refugjatet qe jetojne ne ish Repubiken Jugosllave te Maqedonise, prej romeve,

hashkalinjeve dhe egjyptianeve. Afer 3300 persona jane te regjistruar ne UNHCR².

- Te zhvendosurit qe jetojne ne Serbi dhe Mal te Zi, qe kryesisht jane serbe, rome, hashkalinje, boshnjake dhe gorane. Ne shkurt te vitit 2002 UNHCR ka vleresuar se jane 231 100 te zhvendosur te brendshem qe akoma jane te zhvendosur ne Serbi dhe Mal te Zi.³
- Te zhvendosurit qe jetojne jashte vatrave te tyre por qe kane mbetur n Kosove - qe perfshijne bashkesite serbe, rome, hashkali, egjyptiane, gorane, shqiptare dhe bashkesite tjera minoritare. UNHCR vlereson se 22 500 persona i perkasin kesaj kategorie.⁴ Keta te zhvendosur jane nje pjese e 130 000 serbeve dhe 100 000 joserbeve qe jetojne sot ne Kosove.⁵

Kushtet e jeteses se ketyre te zhvendosurve jane shpesh shume te renda. Ne Maqedoni, rrefugjatet nga Kosova kane vetem status te perkohshem humanitar qe i pengon te punesohen. Shume nga keta rrefugjate jetojne ne dy kampe, njeri prej te cileve gjendet ne nje deponi te meparshme te berllogut.⁶

¹ Në disa area ku serbet jan shumicë shqiptarët nuk kan mundur të kthehen, në Shtërpc dhe 3 komuna të veriore dhe Mitrovicë

² Z.Alvaro Gil-Robers, zytja e Komisionit për Drejtat Njerzore, Këshilli Rvropian, Kosova: Fati I personave të zhvendosur dhe situata e drejtave njerzore, 16 Tetot 2002.

³ UNHCR Pozita ne nevojen e mbrojtjes së vazhdueshme të individave nga Kosova, Prillë 2002

⁴ Gil-Robles, Raporti përmendur më lart, 16 Tetor 2002

⁵ Nga OSBEja Profili Komunave, Gusht 2002, regjistrimi I popullates 1991, sipas OSBEsë ne Kosovë jan 2.3 mil Shqiptarë

⁶ Gil-Robles, Kosova: Situata e Drejtave Njerzore, 16/10/02.

Ne Serbi dhe Mal të Zi, të zhvendosurit nga Kosova - të gjitha kombesive - shpesh ofendohen si "fshatare" ose nganjehere edhe me keq si "shiptari".⁷ Të zhvendosurit nga Kosova dhe refugjatet nga lufta e Bosnes dhe Kroacise që jetojnë në Serbi dhe Mal të Zi përbejnë me shumë se 770 000 të "popullates nën interes" të UNHCR-se.⁸ Banoret e Serbise i konsiderojnë këta refugjate dhe të zhvendosur si konkurrence për vendet e pakta të punës dhe për burimet tjera.

Perderisa qeveria e Serbise dhe e Malit të Zi është përpjekur që të zhvendosurit dhe refugjatet të përfitojnë nga shërbimet sociale si ato shëndetësore dhe arsimore, situata e keqe ekonomike në Serbi dhe Mal të Zi dhe shkalla e lartë e papunesisë ua vështiresojnë të zhvendosurve të gjejnë punë dhe gjetjen e burimeve tjera për jetesë. Për fshataret që kanë token si burim të të ardhurave, zhvendosja i zhvesh nga mjetet e jetesës. Për më tepër, ndihma nga Serbi dhe Mali i Zi po zvogëlohet, dhe si rezultat qendrat kolektive zyrtare të të zhvendosurve gradualisht do të mbyllën.⁹ Perderisa vetëm një përqindje e vogël e të zhvendosurve ende jeton në qendra të tilla, ky proces do të lendojë me të rrezikuarit - ata që nuk kanë familje dhe miq që mund të strehojnë ata, ose ata që nuk kanë mundësi vetestrehimi.

Të zhvendosurit brenda Kosovës ballafaqohen me kushte të njëjta. Shumë prej tyre jetojnë në enklava të mbrojtura ose nëper geto, në mungesë të lirise së levizjes dhe qasjes së shërbimeve esenciale dhe mundësive të punësimit që një liri e tille i sjellë.

Është e paqarte se sa nga të zhvendosurit do të shfrytëzohen të drejtën e kthimit. Edhe pse shumë analistë heshtur e dyshojnë se shumë prej tyre as që do të kthehen, të zhvendosurit shprehin dëshirë të madhe të kthehen. Një raport i sapodale i Keshillit të Evropës perpiqet të vlerësojë numrin e të zhvendosurve serbe që dëshirojnë të kthehen të jetojnë në Kosovë.

Duke marrur përsyshe përberjen socio-profesionale të të zhvendosurve nga Kosova, origjinën e tyre urbane apo rurale në Kosovë, kohezgjatjen e banimit të tyre atje, moshën, faktin se një numër i tyre e ka shitur opronën e vet në Kosovë si dhe kohën që ka kaluar c'prej se ata janë larguar, një vlerësim i përafërt do të ishte një e treta e 230 000 të zhvendosurve nga Kosova preferojnë të integrohen plotësisht në Serbi dhe Mal të Zi (ose vec e kanë bërë një gjë të tilla), një e treta teter është e dëshpëruar të kthehet (kryesisht të moshuarit, popullata fshatare që nuk e ka shitur pronën në Kosovë, që nuk ka profesio që iu lejon fleksibilitet dhe që kanë një lidhshmeri me të fort me token), perderisa e treta tjetër janë të pavendosur.¹⁰

Sic çeket me oshtë, parimet themelore ndërkombëtare udhëzojnë kthimin e këtyre personave. Sidoqë të jete cështja e statusit final e politizon procesin e kthimit, dhe zgjedhja e sajë do të ketë ndikim qenesor në numrin e personave që vendosin të ushtrojnë të drejtën e tyre për tu kthyer.

⁷ "Seljaci" është term Serb për fshatarët, ndërsa "Shiptari" term ofendues për shqiptarët por përdoret edhe për individat tjer nga Kosova

⁸ UNHCR2001Statistikat e Popullates, 7 Qërshor 2002

⁹ Prej 200,000 të zhvendosurve, 8% kanë akomodimet personale, 40% jetojnë me familje, 41% me qira, 7% në qendra kolektive.

¹⁰ Gil-Robles, Kosova: Situata drejtave të njeriut, 16 Tetor 02

II. HIJA E STATUSIT FINAL

Perderisa pvarësia nuk mund të pranohet si kusht për kthim, mungesa e qartësisë së statusit final politik të Kosovës hedhë erresirë mbi procesin e kthimit.¹¹ Për të zhvendosurit, posaqerisht pjestarët e bashkësisë serbe, nuk është e qartë se a janë duke u kthyer në një shtet të ardhshëm të pavarur ku ata do të jenë pakice, apo në një entitet që i mban lidhjet me Serbinë. Perfaqësuesit serbë terheqin vrejtitjen se shumica e pjestarëve të bashkësisë së tyre nuk shohin kurrëfar të ardhme në një Kosovë të pavarur. Ata parashohin se ata që kanë ikur nuk do të kthehen dhe se ata që ende gjenden në Kosovë do të ikin.¹²

Pasiguria e statusit final gjithashtu ndikon në perceptimin e shqiptarëve ndaj kthimit. Ata e shohin zgjedhjen e lokacioneve të kthimit - vecanerisht në rajonin e Pejës si veper për përbushjen e qellimeve politike të Serbisë; ndarje apo kanonizim të Kosovës.¹³ Shumë i konsiderojnë të kthyerit si Kalin Trojan të Serbisë - mekanizem për të sjellur kontrollin dhe ndikimin e qeverisë serbe në disa pjesë të Kosovës.

Perderisa kthimet nëpër gjithë botën kanë dimension politik, në Kosovë procesi i kthimit është edhe më tepër i politizuar për shkak të ceshtjes së statusit. Për të zhvendosurit serbë perdoren si figura shahu në një lojë politike. Disa forca politike në Beograd e shtyejnë kthimin për qellimet e tyre politike - ndarjen apo kantonizimin e Kosovës. Udheheqësit politike serbë e kanë kushtzuar avancimin e kthimit për pjesëmarrje në zgjedhje dhe për bashkëpunimin e përgjithshëm me UNMIK-un. Edhe pse një strategji e tillë është e kuptueshme, e ka ngritur politizimin e procesit.

Bashkësia nderkombëtare në të njëjten kohëdo që kthimet ta bindin Këshillin e Sigurimit se kushtet janë pjekur për diskutimet lidhur me statusin final - një nga ceshtjet kryesore për fillimin e bisedave lidhur me statusin është suksesi i kthimit. Kthimi i serbëve në vatrën e tyre do të sigurojë se se intervenimi i NATO-s i vitit 1999 dhe prezanca e mëpastajshme nderkombëtare nuk dojnë drejt krijimit të një Kosovë njëetnike. Prandaj diplomatët e shohin kthimin si lojë numrash. Sic është shprehur një perfaqësues nderkombëtar, "kur UNMIK-u shkon para këshillit të Sigurimit, ajo çka iu nevojitet janë treguesit konkretë se serbët janë kthyer".¹⁴

Për shkak të politizimit të kthimit në Kosovë, ekziston një rrezik i vertetë se fokusi në numrin e serbëve të kthyer mund të erresoje nevojën që kthimi të bëhet sipas parimeve nderkombëtare. Për më tepër, sic shihet me sa vijon, ka patur dikim në buri të ofruara për të zhvendosurit joserbë në disa rajone të Kosovës.

¹¹ KE argumenton, pasiguria e statusit pengon pajtimin dhe respektimin e drejtave njerzore, Alvaro Gil-Robles 16 Tet 02, ICG pas analizave avokon Pavarsi Kondicionale, shiko raportin; Udhëkryqet e Kosovës-Statusi Final 1 MARS 2002

¹² Intervista e ICG-së me Milorad Todorovic, Nëntor 2002. UNHCR mendon se kjo figurë e Komunitetit serb nuk është e saktë, dhe se nuk është e qartë se sa do të reagonin ndaj pavarësisë së Kosovës. Është e qartë se se kjo varet shumë nga progresi në e mbrojtjes së drejtave të komunitetit serb gjatë periudhës tranzitore.

¹³ Intervista e ICG-së me Sonja Biserko, Komisioni I Helsinkit, tetor 2002.

¹⁴ Intervista e ICG-së me kreun e Zyrës Përfaqësuese në Prishtinë, Nëntor 2002.

III. PARIMET NDERKOMBETARE TE KTHIMIT

RKSKB 1244 e ka ngarkur UNMIK-un që në bashkëpunim me UNHCR-ne dhe KFOR-in të sigurojë "kthimin e sigurt dhe të papenguar të gjithë refugjateve dhe personave të zhvendosur në shtepite e tyre në Kosovë."¹⁵ Duke pasur parasysh që UNMIK-u e administron provincën, kjo bie në pajtim me PARIMET UDHEZUESE LIDHUR ME ZHVENDOSJEN E BRENDSHME, të leshuar nga Perfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me Personat e Zhvendosur Brenda rajonit, Francis deng. Parimet që udhezojnë kthimin janë:

Autoritetet kompetente kanë detyrë primare dhe përgjegjësi të krijojnë kushte, dhe të ofrojnë mjetet që ua mundësojnë të zhvendosurve të brendshëm të kthehen me vullnetin e tyre në siguri dhe dinjitet në shtepite e tyre apo vendbanimet e tyre, ose të rivendosen vullnetarisht në ndonjë pjesë tjetër të vendit. Ato autoritete do të përpiqin lehtësojnë riintegrimin e të kthyerve apo të rivendosurve që kanë qenë të zhvendosur brenda territorit.¹⁶

Keto principe janë të nxjerrura nga ligjet nderkombetare mbi riatdhesimin. Në doracakun mbi riatdhesimin, UNHCR i ka definuar me tutje keto parime - sic është shkicuar me poshtë - por ka shtuar një element: rrezikun e kthimit.

Kthimi i Vullnetshëm: Vendimi për tu kthyer duhet të behet pa detyrim. Që të jete plotësisht e vullnetshme, faktorët pozitiv tërheqës në vendin e origjinës duhet të jenë elementi kryesor për vendimin e refugjateve që të kthehen e jo faktorët shtyës nga vendi ku ata qëndrojnë perkohësisht, ose faktorët negativ tërheqës si kërcenimet ndaj prones.¹⁷

Kthimi në Siguri, Dinjitet dhe Mbrojtje: Të kthyerit duhet t'jane të mbrojtur nga sulmet e armatosura, të

jane të lire nga frika e persekutimit apo denimit, dhe siguria materiale - mundësia e shfrytëzimit të tokës dhe burimeve tjera të jetesës. Kthimi në dinjitet është i pakushtëzuar, sipas hapit të vetë të kthyerve, me respekt dhe pranim të plote nga autoritetet lokale, duke përfshirë këtu kthimin e plote të të drejtave të tyre.¹⁸ Siguria fizike e të kthyerve gjatë të gjitha fazave gjatë dhe pas kthimit duhet të respektohet dhe duhet pasur parasysh sezonat shkollore dhe ato të mbjelljeve.

Rivendosja / Rilokimi: Për shkak se të zhvendosurit nga Kosova kanë mbetur në vendin e tyre të shtetësisë, atyre duhet t'u lejohet të rivendosen në vendbanime tjera brenda vendit. Sic shqyrtohet më poshtë, UNMIK-u dhe autoritetet në Beograd, janë përpjekur ta aplikojnë këtë parim. UNMIK-u ka vendosur që të mbeshtese vetëm kthimin në shtëpi. Nderkohe Beogradi nuk ka ndermarrur asnjë hap për t'u mundësuar banorëve të Kosovës që zyrtarisht ta heqin statusin e rezidencës, përderisa në të njëjtën kohë e shtyne UNMIK-un që t'ua lejoje personave të rivendosen brenda Kosovës.¹⁹ Këshilli i Evropës ka theksuar se "pengesat për kthimin në vendet tjera nga ato origjinale krijojnë probleme serioze në dritën e së drejtës për të zgjedhur vendbanimin brenda territorit të shtetit të vet."²⁰

Rreziket e Kthimit: Edhe pse rreziket e kthimit nuk janë përfshirë në parimet e të zhvendosurve, është një faktor i rëndësishëm që UNHCR-ja i merr parasysh gjatë procesit të riatdhesimit. Kthimi i hershëm mund të jete destabilizues për procesin e ndjeshëm paqësor, dhe i rrezikshëm për vetë të kthyerit. Nëse kthimi i grupeve të mëdha e kërcenon papacitetin absorbues të bashkësisë që i pranon ata, dhe kërcenon sigurinë e të kthyerve, ose nëse pasojat politike të kthimit demtojnë procesin delikat politik, "është përgjegjësi e

¹⁵ Shih UNHCR 1244, 10 qershor 1999, 11 (k)

¹⁶ Zyra e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (OCHA), Parimet udhëheqëse të Zhvendosjes së Brendshme, 1998.

¹⁷ Doracak: Riatdhesimi I Vullnetshëm: Mbrojtja Ndërkombëtare, Gjenevë: Komisioneri I Lartë I Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, 1996.

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Pamundësia e njerëzve për të anuluar regjistrimin e tyre paraqet një pikturë të lakuar të kthimit sepse i ndalon njerëzit nga shprehja e qëllimeve të tyre të vërteta – varrësisht prej asaj se a duan të kthehen ose të qëndrojnë në Serbi dhe Mal të Zi. Intervista e ICG-së me përfaqësuesin e UNHCR-së, nëntor 2002.

²⁰ Gil Robles, Kosovë. Gjendja e të Drejtave të Njeriut, 16 tetor 2002.

UHCR-s te ofroje udhezime dhe ta qartesoje qendrimin e vet."²¹

Perfundimisht personi vendose vet se a eshte ne gjendja te ballafaqohen me rreziqet, dhe bashkesia nderkombetare nuk mund t'i ndaloje njezitet te kthhen nese ata duan. Mirepo nese kushtet jane te rrezikshme per te kthyerit, bashkesia nderkombetare duhete ta shqyrtoje me kujdes se cfare mbeshtetje i ofron procesit te kthimit. Rreziku i mundshem per te kthyerit dikton dallimin midis "lehtesimit" dhe "nxitjes" se kthimit. Bashkesia nderkombetare mund te lehtesoje kthimin "kur refugjatet trgojen deshire te madhe te kthehen vullnetarisht dhe/ose kane filluar te bejne nje gje te tille me veteiniciative edhe ne rast kur UNHCR-ja nuk e konsideron nje gje te tille, faktikisht eshte e sigurt per shumicen e refugjateve te kthehen".²²

Qe bashkesia nderkombetare aktivisht ta nxise kthimin e te zhvendosurve, duhet te kete nje permiresim te pergjithshem i situates ne vendin e origjines ne menyre qe te jete i mundshem kthimi ne siguri dhe dinjitet per shumicen e refugjateve.²³

Sic shihet me poshte, UNHCR dhe UNMIK-u eshte perpjekur qe t siguroje respektimin dhe implementimin e ketyre principeve ne kushtet e komplikuar te kthimit ne Kosove.

IV. PERPJEKJET FILLESTARE TE KTHIMIT TE TE ZHVENDOSURVE

A. POLITIKA E KTHIMIT TE HERSHEM

Ne fund te vitit 1999 dhe gjate vitit 2000, UNMIK-u dhe KFOR-i jane kritikuar ashpër per ekzodusin e minoriteteve nga Kosova dhe jane perballur me presion te madh politik qe te lehtesoje kthimin e tyre. Ne fillim te vitit 2000 bashkesia serbe e ka bere permirsimin e kthimit si kusht per bashkunim me UNMIK-un dhe pjesmarrjen ne strukturat politike te Kosoves.²⁴

Per shkak te rethanave te veshtira per bashkesite minoritare, UNMIK-u dhe UNHCR-ja kane ndjere se eshte heret qe te mbeshtet kthimi nga bashkesia nderkombetare. Ata kane deklaruar se parakushtet per kthim te sigurt dhe dinjitoz nuk mund te sigurohen. Ne mars te vitit 2000 UNMIK-u i ka raportuar Keshillit te Sigurimit se "situata e tanishme per popullaten minoritare eshte e tille qe kthimi i tyre ne Kosove nuk mund te mbeshtet apo letesohet nga UNHCR-ja per arsye se parakushtet per ambient te sigurt nuk jane pjekur."²⁵

Per t'ju pergjegjur kerkesave nga perfaqsesit serb, qe te punohet ne procesin e kthimit UNMIK-u ka nisur nje detyre per te shqyrtuar menytrat se si mund te krijohen kushtet per kthim. PSSP i atehershem Bernard Kushner e ka themeluar "Komitetin e perbashket per kthimin e serbeve te Kosoves" (JCR) ne Maj te vitit 2000. UNHCR-ja ka ndermare udheheqjen e JCR-se antaret e te cilit perfshinin UNMIK-un, KFOR-in dhe OSCE-ne.

Mandati i JCR-se ishte te "shqyrtonte mundesite e kthimit te sigurt dhe te rregullt te serbeve te zhvendosur te Kosoves, qe duan te kthehen ne shtepite e tyre dhe te kordinonte te gjitha

²¹ Ibid

²² Ibid

²³ Ibid.

²⁴ Agence France-Presse, Serbët përfundojnë bojkotin gjashtë mujësh të forumit konsultativ të Kosovës, 12 prill 2000.

²⁵ Raporti I Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 3 mars 2000

perpjekjet dhe inicjativat ne kete drejtim."²⁶ Ne Janar te vitit 2001, JCR-ja e ka leshuar KORNIZEN PER KTHIMIN E SERBEVE 2001. Kjo kornize i ka paraqitur parimet e kthimit per te zhvendosurit serb qe perfshinte te drejten e kthimit vullnetare ne vendin e prejardhjes. Dokumenti gjithashtu ka theksuar kushtet minimale qe duhen per kthim, duke perfshire te drejten e levizjes, strehimit dhe te shfrytezimit te sherbimeve publike.²⁷

Korniza e JCR-se i ka theksuar njezet e pese lokacione te mundshme te kthimit, i ka paraqitur masat per mbeshteten e proqesit te kthimit, dhe eshte pajtuar me rolin dhe pergjegjesit e vepruesve kryesore te angazhuar ne procesin e kthimit dhe riintegrimin. Me 8 Qershor 2001, keshilli i administrimit te perkohshem i ka aprovuar parimet e konceptit te kthimit dhe ja ka paraqitur donatoreve ndrkombetare me 29 Qershor.

Nje proces paralel eshte themeluar per Romet, Hashkalinjet dhe Egjiptianet e zhvendosur. Ne Prill te vitit 2000 perfaqsuasit e ketyre bashkesive dhe lideret politike Shqiptare aprovuan PLATFORMEN PER VEPRIM TE PERBASHKET PER ROMET, HASHKALINJET DHE EGJIPTJANET. Platforma i ka identifikuar qeshtjet kryesore per kete bashkesi, duke perfshire arsimimin, mireqenjen sociale dhe mbestetjet tjera si she mbeshtetjen e duhur per kthimin e te zhvedosurve ne shtepite e tyre.

B. PROGRESI I HERSHEM I KTHIMIT

Megjithë rritjen e diskutimeve politike per kthim, shume pak progres eshte arritur ne dy vitet e para te misionit te KB-se. Kryesisht per shkak te rethanave, numrit te minoritareve qe linin Kosoven vazhdonte te jete me i madhe se numri i atyre qe ktheheshin. Ne vitin 2000 vetem 1800 persona jane kthyer spontanisht, derisa ne vitin 2001 kjo figure ka rene vetem ne 500 persona. Kjo renie e kthimit spontan ne vitin 2001 eshte spjeguar pjeserisht per shkak te bombardimit te Nis Express ne shkurt te po atij viti. Njembdhjete serb jane

vrare perderisa autobusi i tyre nga Nisi u sulmua ne nje akt te paramenduar terrorizmi. Ky incident ndodhi ne prag te pranveres - ne periudhen ku njerezit vendosin te kthehen per t'i perpunuar fushat e tyre dhe per t'i ndrequr shtepite e tyre para dimrit.²⁸ Edhe pse tre persona u mbajten ne arrest lidhur me kete incident nje iku dhe dy te tjeret u leshuan per shkak te mungeses te fakteve.

Mirepo, bombardimi i Nis Expressnuk ishte akt i vetem i dhunes. Kjo ndodhi ne rrethanat e veshtirsuara per bashkesite minoritare. Siq raportonte UNHCR ne vitin 2001:

Mungesa e interesit per kthim nuk eshte produkt i brengave lidhur me sigurine fizike siq eshte demonstruar nga fakti se edhe enklavat eksistuese qe gezojne siguri relativisht stabile brenda rajoneve te mbrojtura nuk kane pasur kthim spontan te banoreve te tyre te meherhem... Te zhvendosurit e shohin kthimin e Kosove si te paqendrueshem sa i perket cilesise se jetes, ne mungese se lirise se levizjes, mungeses se perpektives per mbijetes ekonomike, mungeses se sherbimeve shendetsore dhe arsimore ne disa raste. Ne shume rajone demtimi i prones dhe marrja ilegale e prones perfaqson nje pengese tjeter per kthim.²⁹

Kthimi i minoriteteve tjera ishte gjithashtu i veshtire pasi qe kushtet ne Kosove vazhduan te jene te ashpra. Shume refugjate Rome ne Maqedoni do te vazhdonin me me qejf te jene te zhvendosur se sa te kthehen ne Kosove: "... afer 70 % e Romeve te Kosoves qe ishin refugjate dhe qe e lane Maqedonine nr vitin 2001 faktikisht u rivendosen ne Serbi me gjithë kushtet e veshtira materiale, se sa te kthehen ne Kosove ne kushtet ekzistuese."³⁰

Edhe pse Kosova ka perjetuar disa kthime ne vitin 2000 dhe 2001, disa trende i kane karakterizuar proceset e hershme te kthimit. Te thyerit jane

²⁶ Raporti I Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 6 qershor 2000

²⁷ Shih Komitetin e Përbashklët të Kthimeve të Serbëve të Kosovës, Korniza e Kthimeve 2001, 13 janar 2001

²⁸ UNHCR/OSBE Vlerësimi I nëntë I Gjendjes së Minoriteteve etnike në Kosovë Periudha nga shtatori 2001 deri në prill 2002.

²⁹ UNHCR, Raporti nga UNHCR Kosova drejtuar Komitetit Drejtues të Komitetit të Përbashkët mbi Kthimin e Serbëve të Kosovës (JCR) Vlerësimi I Situatës, Aktivitetet dhe Zhvillimet Sektorale në Lokalitetet e Mundshme të Kthimit, 1 prill – 31 korrik, 2001.

³⁰ UNHCR/OSBE Vlerësimi I Nëntë Shtator 2001 – Prill 2002.

vendosur ne enklavat e themeluara, me liri te kufizuar levizjeje duke konsoliduar keshtu enklavizimin e jetes minoritare ne Kosove.³¹ Shpesh vetem nje pjese e famijes eshte kthyer, ngase faktoret shtytes me shume se faktoret nxites e kane diktuar procesin e kthimit. Dhe shumica e te kthyerve i kane permendur kushtet e veshtira te jeteses ne rajonin e rivendosjes si arsye kryesore per khimin e tyre.³²

V. STUDIMET E RASTEVE: DY REGJIONE TE NDRYSHME

Ne vitin 2002, situata e kthimit kishte ndryshuar paksa. Numri i monoritarve qe e leshonin Kosoven kishte rene dhe 2467 te szhvendosur ishin kthyer ne province nga janari dei me 31 dhjetor te vitit 2002. kjo e rriti numrin e pergjithshem te te kthyerve ne mbi 5800 midis viteve 2000 dhe 2002.

Sipas UNHCR-s, popullaten e zhvendosur te Kosoves e perbnin 68 per qind serbe, 13 perqind rome, hashkalinj dhe egjyptiane, kater perqind boshnjake, tete per qind malazeze dhe shtate perqinde komunitetet tjera.³³

Kthimet e deritanishme pergjithesisht reflektojne nje ndarje te tille. Pesdhjete e tete perqind e numrit te pergjithshem te te kthyerve jne serbe, mbi 21 perqind jane hashkalinje dhe egjyptiane, mbi dhjete perqind jane rome, pese perqind jane shqiptare (ne rajonet ku kane qene paice), kater perqind boshnjake, dhe nje perqind jane gorane.³⁴

Ndrja regjionle e kthimeve qe nga 2000 deri me tani eshte kjo (shih aneksin nje er harten e Kosoves):

- ❑ Rajoni i Prishtines: 44 perqind e te kthyerve (63 % serbe, 10%rome, dhe 27% te kthyer hashkalinje dhe eghyptiane);
- ❑ Rajoni i Pejës: 21% i numrit te pergjithshem te te kthyerve (59% serbe, 4.7% rome, 30.4% hashkalinje/egjyptiane, dhe 6% boshnjake)
- ❑ Rajoni i Gjilanit: 17.5% i numrit te pergjithshem (55.7 % serbe, 16.4% rome, 6.6% hashkalinje dhe 21.4% shqitare);

³¹ Ibid.

³² Prevalenca e faktorëve shtytës e vë në dyshim parimin e kthimit vullnetar vecanërisht për arsye se mungesa e alternativave për tirivendosur në ndonjë lokalitet tjetër ndikon në mundësinë e ushtrimit të vendimit të lirë për tu kthyer nga ana e të zhvendosurve.

³³ UNHCR janar 2002 StaTISTIKAT E unmik-UT, Strategjia e 2003 për Kthime të Qëndrueshme, Takimi për Koordinimin e Donatorëve për Kosovë 5 Nëntor 2002.

³⁴ UNHCR, “Kthimet e te Zhvendosurve të Brendshëm dhe të Jashtëm të Minoriteteve sipas Rajonit – Numrat dhe Përqindjet,” deri më 31 tetor 2002. Përderisa numri I të kthyerve e reflekton përfaqësisht ndarjen etnike të zhvendosjeve, mbështetja e këtyre të zhvendosurve nuk shpërndahet në mënyre të barabartë në të gjitha rajonet, sic është bërë e qartë nga bisedat tona të mëposhtme në Pejë.

- Rajoni i Mitrovices: 9% i numrit të ergjithshëm (58% serbe, 1% rome, 24.7% hashkalinje dhe 16% shqiptare);
- Rajoni i Prizrenit: 8.5% i numrit të përgjithshëm (41% serbe, 17.1% rome, 1.8% hashkalinje/egjyptiane, 27% boshnjake dhe 13.5% gorane).³⁵

Edhe pse Prishtina e ka shkallen me të lartë të kthimit, shumica e këtyre personave janë kthyer në enklava gjatë viteve 2000 dhe 2001.

Rajonet me numër më të madh të kthyerve në vitin 2002 janë Peja dhe Gjilani. Përderisa që të dyja kanë pasur sukses në këtë proces, mënyra e kthimit ka qenë dramatisht e ndryshme. Në rajonin e Pejës është theksuar kthimi i serbeve në mënyrë të organizuar në baze të parazgjedhejes së venbanimit, përderisa në Gjilan përpjekjet e kthimit me shumë janë drejtuar me pak kah niveli i iniciativave të politizuara të komunitetit për të mbështetur kthimin spontan nëpërmjet projekteve të organizuar që kanë mundësuar kthimin e përzier. Siç shihet më poshtë këto ndryshime metodologjike kanë pasur pasoja për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e procesit.

A. PEJE: KTHIMI I ORGANIZUAR NË NJE RAJON TË VESHTIRË

Rajoni i Pejës - që përfshinë komunat e Pejës, Deqanit, Gjakovës, Istogut dhe Klina, ishte me i goditur nga lufta. Gjatë viteve 1998, 1999, mbi 57% e shtëpive ishin shkatërruar nga veprimet e ushtrisë ugosllave dhe njesive paramilitare.

Pas vitit 1999, u shkatërruan shumica e shtëpive që u takonin pjesëtarëve të komunitetit serb. Përderisa një vlerësim i përgjithshëm i dëmeve të haktura të shtëpive të minoriteteve, shumica e serbeve e këtij rajoni kanë ikur në verë të vitit 1999.

Shumica e serbeve në rajonin e Pejës kanë ikur sëbashku me tërheqjen e trupave jugosllave të sigurimit.³⁶ Afër 1200 serbe mbeten në rajon duke

jetuar në manastire si dhe në dy fshatra - Gorazhdec, në komune të Pejës, dhe Crkolez, në komunën e Istogut.

Gorazhdeci është fshat i banuar me serbe me afër 800 baorë dhe gjendet vetëm disa kilometra larg Pejës. Megjithatë rruga që kalon nëpër Gorazhdec i lidhë fshatrat shqiptare me Pejë, banorët e sajë janë të izoluar nga fqinjët shqiptarë dhe nën mbrojtjen e KFOR-it. Ata refuzojnë të bashkëjetojnë me shqiptarët, bile ua kanë ndaluar edhe femijëve të tyre të fshatrave përreth ta përdorin shkollën e tyre. Përderisa hedhja e vazhdueshme e gureve dhe format tjerë të kercenimit janë të vazhdueshme, nuk ka pasur incidente të rënda sigurimi deri në fund të gushtit 2002 kur banorët e fshatit u gjuajtën me armë zjarri përderisa ishin duke prerë dru, edhe pse ishin nën përcjelljen e policisë së UN-së. Edhe pse askush nuk vra apo lëndua, KFOR-i dhe policia nuk arrestoi asnjëri për qëndruan për disa orë rresht.³⁷

Fshati Crkolez në komunën e ISTOG-ut është fshati i vetëm i përzier në këtë rajon. Popullata serbe mbetet e pandryshueshme, rreth 85 persona. Fshati ishte skenë e tensioneve të mëdha gjatë vitit 2002, me disa incidente të shtënash zjarri dhe djegiesh shtëpish të serbeve.³⁸ Mirepo siguria gradualisht është përmirësuar. Serbet tani mund të udhetojnë në pjesë shqiptare të fshatit dhe u lejohet përcdo ditë e më shumë të shkojnë nëpër tokat e tyre për punë bujqesore. Një përfaqësues serb nga Crkolezhi merr pjesë në Kuvendin Komunal, e kryeson nën-zyren komunale në fshat, dhe bashkëpunon me kolegun

jetuar në komunën e Pejës (gjashtë për qind e popullsisë), përderisa ka pasur mbi 4,442 romë, dhe 19 000 opjestarë të komuniteteve tjera. Tash janë afër 1000 serbë, dhe 11 300 minoritarë jo-serbë. Në vitin 1991 Deqani kishte 800 serbë dhe përreth 800 minoritarë tjerë; tani për tani ka vetëm 20 serbë dhe 472 minoritarë jo-serbë; më 1991 Gjakova kishte një popullsi prej 3000 serbësh ndërsa tani ka vetëm 6 serbë; Istogu ka pasur 6000 serbë dhe 5600 minoritarë tjerë e tani ka 256 serbë dhe 1733 minoritarë jo-serbë, dhe Klina ka pasur mbi 5000 serbë dhe mbi 1000 romë, përderisa tani ka vetëm të kthyerit e Bicës dhe Grabacit (41 familje) dhe 1126 minoritarë jo-serbë. Shih OSBE, Dosjet Komunale Gusht 2002.

³⁷ Lajmet e BBC-së, Të Armatosurit Sulmojnë Paqëruajtësit e Kosovës, 29 gusht 2002.

³⁸ UNHCR/OSBE, Vlerësimet Preliminare, Korrik 1999

³⁵ UNHCR, "Kthimet e Minoritarëve" 31 tetor 2002.

³⁶ UNHCR/OSBE, Vlerësimet Paraprake Të Gjendjes së Minoriteteve Etnike në Kosovë Korrik 1999. Regjistrimi I vitit 1991 ka shënuar numrin prej 7800 serbëve të Kosovës që kanë

e tij shqiptar.³⁹ Mirepo mungesa e kthimit spontan ne kete fshat deshmon per vazhdimesine e kushteve te veshtira.

Afr 10 000 rome dhe hashkalinje dhe egjypiane jetojne ne kete rajon, dhe perafersisht 7500 tjere vazhdojen te qendrojnë ne Mal te Zi.⁴⁰ Gjithashtu ekziston nje numer i konsiderueshem boshnjakesh te zhvendosur. Perderisa liria e levizjes siguria e pergjithshme eshte permiresuar per keto grupe, qasja ne sherbimet e rindertimit dhe sherbimet tjera mbetet problematike.

Perdersa te zhvendosurit rome, hashkalinje dhe egjypiane jane kthyer spontanisht, kthimi i serbeve ka qene i organizuar, i mbeshtetur me fonde te mjaftueshme dhe kontravers. Edhe pse vleresimi i Komunitetit te Perbashket mbi kthimin e Serbeve i vitit 2001 ka pare pak mundesi per kthimin e serbev, planifikimi pat vazhduar. Istogu ishte deshmitar i kthimit te pare te organizuar te serbeve ne fushen e Osojanes ne gusht 2001. Nje projekt tjetër ktheu disa familje ne rajonin e Klina ne gusht 2002.

Disa ekane pershkruar procesin e kthimit ne rajonin e Pejës si proces i "mbrapshte": ne vend se te personat ta zgjedhin vendin e kthimit, se pari eshte caktuar vendbanimi, pastaj jane kerkuar nerezit per t'u kthyer.⁴¹ Ne kthimet e deritanishme projektet shpalosen ne kete menyre:

- Vendi zgjedhet per kthim dhe fondet kerkohen per ate lokacion;
- Qendra per Kordinim e Kosoves (CCK) dhe UNMIK-u kerkojnë nga zyra e UNHCR-se ne

Beograd te kerkoje nevojtare (ish banoret) qe pyeten nese duan te kthehen n ato rajone.⁴²

- te kthyerit kontrollohen se a kane prone ne fshatin ecaktuar dhe se a paraqesin rrezik sigurie; Rajoni ishte gjithashtu
- Personat kthehen ne Kosove dhe fillon rindertimi i shtepive te tyre.

Zyra rajonale e UNMIK-ut ne Peje ka qene shume e kycur ne procesin e kthimit. Jane themeluar nje njesi projektimi dhe nje njesi pajtimi per te bre mbikqyrjen e kthimeve ne ate rajon. Zyra e UNMIK-ut ka pasur qllimet me te mira me masat e tilla - kthimin e e personave ne shtepite e tyre - dhe eshte përnallur me rrethana shume te veshtira implementimi. Sidoqte te jete pyetje serioze ka rreth asaj se si jane trajtuar kthimet dhe rreth implikimeve te atij procesi.

1. Fusha Osojanit: Krijimi i nje Enklave te re Serbe

Osojani gjendet ne fushen afer kufirit me Malin e Zi dhe Serbine. Pra lufte serbet kane dominuar ne kete fushe, por te gjithë kane ikur me 17 Qershor 1999.⁴³ Shtepite e tyre prgjithesisht jane shkaterruar pas ikjes se tyre, dhe fusha ka mbetur e braktisur.

Plani i kthimit te serbeve ne Osojan ne esence ka qene politik. Bashkesia nderkombetare ka insistuar ne kthimin e njerezve ne Kosove, dhe fusha e Osojanit ka qene nje opcion atraktiv. Fshatrat jane relativisht te izoluara nga viset e banuara me shqiptare me vetem tri familje shqiptare ne fushe.⁴⁴ Rajon githashtu ka qene afer Mitrovices, keshtu qe linjat e autobuseve ua kane mudesuar lidhjen me rajonet me dominim serb ku ata kane mundur te blejne gjera lirisht dhe kane mundur ti marrin sherbimet sekondaredhe terciarre mjeksore.

Projekti per kthim ne Osojan nuk ka qene pa pengesa. KfFOR pat vleresuar se "kthimet n kee rajon mund te ngrisin tensionin, vecanerisht ne

³⁹ UNHCR, Raporti nga UNHCR në Kosovë për Komunitetin Drejtues të Komitetit të Përbashkët mbi Kthimin e Serbëve të Kosovës (JCR) 1 Prill – 31 Korrik 2001

⁴⁰ UNHCR/UNMIK, Informimi I Donatorëve lidhur me Kthimet, 7 maj 2002. Refugees International ka vlerësuar se 50 5 të të zhvendosurve rome nuk janë të regjistruar, pra kjo figurë është e ulët. Shih, Refugees International Bulletin "Romët: Më të Rrezikuarit e Ballkanit" 18 shtator 2002.

⁴¹ Për ta siguruar natyrën vullnetare të kthimeve, vecanerisht në një ambient me siguri të rrezikuar, të kthyerit së pari duhet të shprehin vullnetin e tyre për tu kthyer, dhe pastaj duhet të zbatohet kthimi i organizuar, Intervista e ICG-së, tetor 2002.

⁴² Intervista e ICG-së me përfaqësuesin e UNHCR-së, nëntor 2002.

⁴³ Intervista e OCG-së me banorët e Osojanit, nëntor 2002

⁴⁴ Fshatrat kryesisht serbe në Osojan ishin Osojane, Tucep, Zvecan dhe Prepan. Fshatrat e përziera përfshinin Belicën, Kacin, Koshin dhe Shalinovcin.

komunitet qinje të Klina dhe Skenderajt për shkak të problemeve lidhur me lirinë e lëvizjes dhe qasjes së shërbimeve publike. Për më tepër UNHCR-jua ka dhënë vërejtjen "të kthyerit në këto vende duhet të presin të kthehen në enklava dhe se mjetet për qarkullim do të jenë të nevojshme."⁴⁵

Me gjithë këto bregat, 54 serbë janë kthyer në Osojanë më 13 gusht 2001 nën mbrojtjen e KFOR-it spanjoll. Projekti - i financuar nga qeveritë franceze dhe gjermane - është krijuar për hapin e ngadllshëm të rindertimeve si dhe për kohezgjatjen; kthimi në gusht ka nënkuptuar se personat e kthyer nuk munden t'i mbjellin kopshtet e tyre dhe se janë të verur gjatë tërë dimrit.⁴⁶ Dimri i parë ka qenë shumë i vështirë, shumë të kthyer kanë qenë pensionerë dhe kanë jetuar në tenda. Në verë 2002, pak më shumë se 200 persona ishin kthyer në rajon. Gjithsej shtatëdhjetë e tri shtëpi janë rindërtuar, me vetëm pesë prej tyre pa elektricitet në vjeshtë 2002.⁴⁷ Mirepo bashkësisë prapë i mungon rrjeti i telefonit. Qendra për Kordinim të Kosovës dhe metohisë ka planifikuar t'i japë ndihmë shtesë këtu rajoni në shtëpi të prefabrikuar disa prej të cilave kanë arritur në vjeshtë të vitit 2002 përderisja tjerat arrijnë në pranverë.

Disa lëshime kanë ndodhur për shkak se objektivat politike e kanë udhëhequr projektin. Kthimi është mendur vetëm si rindërtim i shtëpive dhe projektet për krijimin e të ardhurave nuk janë implementuar deri në një vit më vonë. Shumë nga të kthyerit ishin pleq dhe si të tillë nuk kishin fuqi të rindërtimit shtëpive të tyre.⁴⁸ Kthimi në Osojanë krijoi një enklavë të re në Kosovë. Hyrjet dhe daljet mbeten ende të mbrojtura, i gjithë territori patullohet dhe vetëm banorët dhe ata që merrin lejen lejohen të hyjnë brenda. KFOR-i i ka fotografuar e të gjithë banorëve dhe kopjet e tyre mbahen në pikën hyrëse të luginës.⁴⁹ Ky proces nuk mund të llogaritet si

kthim në siguri dhe dinjitet, por nëse qëllimi i kthimit është ndarja.

Pak është bërë për të përgaditur fshatrat shqiptarë përreth me kthimin pasi që "nuk ka ekzistuar ambienti i përshtatshëm për diaog dhe sendertimin e mirebesimit në mes të serbëve dhe shqiptarëve para kthimit"⁵⁰ Edhe pse është implementuar një "projekt balancimi"⁵¹ - këtu shtëpi janë rindërtuar dhe janë ndërmarrur disa projekte sociale në rajonet përreth - interesi dhe bregat e popullatës pranuese nuk është marrur në konsiderim.⁵² Lideret komuna në komunën e Istogut nuk janë konsultuar për planifikimin e projektit dhe kjo ka krijuar dyshime se të kthyerit nuk kanë qenë banorë të mëhershëm të Osojanit.⁵³

Një numër protestash iu përgjegj të kthyerve. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës Ramush Haradinaj ndërvenoi për ta qetesuar komunitetin dhe protestat pushuan. Mirepo lideret politike të këtu janë të pakënaqur për kthimin.⁵⁴ Ata thonë se janë për kthimin e njerzve nëpër shtëpitë e tyre por janë kundër kthimeve të organizuara masive. Kjo është një çështje e paqarte: në këto kushte si mund të kthehen serbët spontanisht përpos në kthime të organizuara?

Në verë të 2001, UNHCR dhe UNMIK-u ndërmorren iniciativën për të zvogëluar vartësinë e komunitetit ngandihmat. Disa projekte të vogla u realizuan, kryesisht të ektorit bujqësor. Mirepo stimulimi i metutjeshëm është i nevojshëm neqoftese dëshirohet që komuniteti të mbetet ekonomikisht i ... Pësemdhjetë të rinjë e braktisn luginën për shkak të pamundësisë së punësimit Në qoftëse nuk bëhet më shumë lidhur me situatën ekonomike të komunitetit, gjendja e sajë mbetet jo sigurt.

⁴⁵ Komiteti i Përbashkët për Kthimin e Serbëve të Kosovës, Korniza e Kthimit 2001, Janar 2001.

⁴⁶ UNHCR, Lugina e Osojanit – Fakte. 14 shtator 2001. për shkak se shumë të kthyer ishin pleq, ata nuk mund të ndihmonin në rindërtimin e shtëpive të tyre. Intervista e ICG-së me Administratorin Lokal, Istog, shtator 2002.

⁴⁷ Intervista e ICG-së me Administratorin Lokal, Istog, shtator 2002.

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ Intervista e ICG-së me UNHCR-në, shtator 2002.

⁵⁰ UNHCR/OSBE Vlerësimi I Nëntë shtator 2001 – prill 2002.

⁵¹ UNHCR e përdor këtë term për të përshkruar projektet e zbatuara në mënyrë që komuniteti pranues mos ta marrë përfitime/kushte të pabarabarta.

⁵² Intervista e ICG-së me Administratorin Komunal, Istog, shtator 2002.

⁵³ Intervista e ICG-së me zëvendës-kryetarin, Komuna e Istogut, shtator 2002. Në kthimin e Osojanit, regjistrat komunal të kadastrës nuk ishin kontrolluar për të siguruar kthimin e personave në shtëpitë e tyre.

⁵⁴ Ibid.

KFOR-i vazhdon të jete prezent dhe banoret e lugines i kane thene ICG-se se kane shume pa kontakte me fqinjët e tyre shqiptarë.⁵⁵ Si hap i vogël ne OJQ spanjolle ka filluar një projekt për ta nxitur diaogu në mes fëmijëve të moshës 13 vjecare nga Osojani (serbë) dhe nga fshati Kosh (shqiptarë). Shkollat fillimisht janë "binjakëzuar" dhe do të bejne pikniqe të përbashkëta ne zonat neutrale. Kjo ka pasur nje efekt përtej fëmijënve - prindërit në Osojan kanë propozuar organizimin e një grupi që fqinjët shqiptarë ta shohin se ku shkojnë për vizitë fëmijët e yre.⁵⁶ Iniciativat e tilla qe nxisin hapa të vegjël drejt bashkëjetesës paqësore jane esenciale per vazhdimin e procesit të kthimit.

Problemi kryesor i këtij projekti ishte mënyra e kthimit. Kushtet nuk kane ekzistuar para kthimit - fshatrat nuk kanë mundur t'i shfrytëzojnë shërbimet esenciale, komuniteti pranues nuk ka qenë i përgaditur për kthimin, dhe mundësitë ekonomike dhe sfrytëzimi i shërbimeve ublike nuk janë adresuar me kohë.

2. Kthimi i Serbëve në Klinë

Kthimi i organizuar në fshatrat e Klinës ka filluar me kthimin e familjeve serbe në fshatrat Binxhë dhe Grabc në verë dhe vjeshtë të hershme të vitit 2002.

Ky rajon është mjaft problmatik për kthim. Lufta pat filuar në fushën fqinje të drenicës në 1998 dhe është përhapur shpejt në Klinë. Ky rajonka qenë nga më të goditurit gjatë bombardimeve më 1998/1999. Më shumë se 300 persona janë vvarë, dhe 135 tjerë ende janë të zhdukur. Më shumë se 4250 shtëpi jan shkatërruar dhe shtatë ndërmarrje komunale janë shkatërruar.⁵⁷ Serbët e fshatrave Binxhe dhe Grabc kanë ikur nga Kosova me 16 Qershor 1999, pas një egzodusi të ngjashëm në Pejë.

Kjo komune ka deshmuar edhe agresion poitik. Me 23 Prill 2001eshte vvarë krytari i kuvendit të

komunës.⁵⁸ Kryetari i tanishëm i komunës, i cili është lutur ta përkrahë kthimin i ka të zhdukur shtatë anëtarë të familjes. Ai thotë që baskësia ndërkombëtare duhet të bejë dicka për fatin e të zhdukurve para se të presë qe shqiptarët t'i pranojnë kthimet. Derisa liderët politikë nuk e kanë refuzuar projektin e kthimit dhe kryetari i komunës e ka vizituar lokacionin disa herë, pranimi i tyre duket i mllefosur.⁵⁹

Protestat publike në fshatrat përreth kanë kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare qe të merret më shumë më fatin e të zhdukurve para se të merren me kthimet.⁶⁰

Projekti i kthimeve i financuar nga qeveria gjermane ua ka mundësuar 41 personave të kthehen në shtëpitë e tyre ne Binxhë dhe Grabc. Rajoni ka qenë plotësisht i shkatërruar; të gjitha shtëpitë kanë qenë të rrafshuara për tokë dhe këto dy fshatra nuk i kanë pasur as infrastrukturen dhe shërbimet elementare si rrymë, ujë, shkollë e as shtëpi shëndeti.

Përderisa UNMIK ka thënë se të gjitha gjërat janë mesuar gjatë kthimeve në Binxhe, UNHCR mendon ndryshe.⁶¹ Ata thonë se arakushtet për kthim nuk janë plotësuar para kthimit. Kryesisht për arsye se kthimi nuk ka qenë i organizuar dhe përgaditjet më të mira kanë mundur të bëhen. Personat që janë kthyer në gusht e kanë gjetur fshatin plotësisht të shkatërruar pa asnjë kusht të plotësuar si rryma dhe uji.⁶² Pas kthimit kanë pasur probleme me ujë dhe KFOR-i e ka siguruar një gjenerator per furnizim me rrymë.

⁵⁸ UNHCR është e mendimit se vrasja jo vetëm që ka ndaluar bisedimet për kthim në Klinë, por gjithashtu e ka ngritur tensionin në Osojan. UNHCR, Raporti nga UNHCR në Kosovë për Komunitetin Drejtues të Komitetit të Përbashkët mbi Kthimin e Serbëve të Kosovës (JCR) 1 Prill - 31 Korrik 2001.

⁵⁹ Intervista e ICG-së me Kryetarin, Komuna e Klinës, tetor 2002

⁶⁰ Intervista e ICG-së me Administrorin Komunal të UNMIK-ut, Klinë, tetor 2002, dhe UNHCRnëntor 2002. PërderisAdministratori Komunal I UNMIK-ut shprehet se protestat nuk kanë qenë kundër kthimeve, interpretimi I UNHCR-së është nryshe

⁶¹ Intervista eICG-së me Peggy Hicks, nëntor 2002. Informatat e dhëna nga Zyra në Terren e UNHCR-së, nëntor 2002

⁶² Informatat e dhëna nga Zyra në Terren e UNHCR-së, nëntor 2002

⁵⁵ Intervista e ICG-së me banorët e luginës së Osojanit, nëntor 2002.

⁵⁶ Intervista e ICG-së me përfaqësuesin e UNHCR-se, nëntor 2002.

⁵⁷ Intervista e ICG-së me Kryetarin, Komuna e Klinës, tetor 2002.

Përderisa 41 personat janë strehuar dhe rindërtimi pritet të përfundohet në dhjetor 2002, ka pasur akuza se regjistrat komunal te kadastrës nuk janë konsultuar gjatë rindërtimeve. Një shtëpi është ndërtuar ne tokën e komunës dhe do të kthehet ne ndërtesë të komunës.⁶³

Koha e kthimeve ka qenë me vonesë për mbjelljen e kopshteve dhe të lashtave tjera duke i bërë të varur gjatë dimrit. Banorët e këtyre fshatrave ankohen serindërtimi ka filluar me vonesë, nuk ka mundësi punësimi, dhe se janë të varur gjatë dimrit. Fshatrat tanipërtani janë duke marrur ndihmë ushqimore që kryesisht vjen nga manastiri i Deqanit.⁶⁴ Është shtuar komponenta per fitimin e të ardhurave, një OJQ ka filluar këtë proces.

Për më tepër ata kanë pasur shumë pakë liri lëvizjeje, përderisa fshatrat nuk janë larg nga Osojani, nuk ka anjë lidhje transporti që shpi në Osojan e as në Mitrovicën veriore. Fshatarët janë plotësisht të varura nga zemërgjerësia e KFOR-it për nevojat e transportit.⁶⁵ Kjo e rritë edhe më tepër izolimin e tyre.

Mungesa e irisë së lëvizjes paraqet një problem të vecantë për shfrytëzimin e shërbimeve publike. Shërbimet ublike si përkujdesi shëndetësor dhe dhe shkola, janë adresuar ad hok pas kthimit të personave. Dy herë në javë KFOR-i i përcjellë për fshatin fqinj shqiptarë ku shkojnë për vizita mjeksore. Bile edhe në raste emergjence banorët janë të varur nga KFOR-i.⁶⁶

Të kthyerit nuk kanë asnjë kontakt me komunitetin përreth. Përderisa UNMIK-u pohon se ka pasur dialog para kthimit, pasiqë përfaqësuesit komunal kanë marrur pjesë në grupin punues komunal, kjo nuk është njësoj si të përgaditenfshatrat përreth per kthim. Banorët e fshatit më të aferm, Shtupël, pohojnë se askush nuk ka biseduar me ta për kthimin para se të kthehen serbët, nuk është mbajtur asnjë mbledhje bashkësie e asnjë fushatë

informimi. Edhese UNMIK-u i ka ndaluar disa person rrugës dhe i ka pyetu për mendimin e tyre lidhur me kthimin, fshaarët ankohen se një çështje me rëndësi nuk mund të diskutohet në mënyrë aq të rastësishme.⁶⁷

3. Kthimi i Planifikuar i Serbëve në Pejë

Udhëheqësit e bashkësisë së Gorazhdecit e kanë nxitur kthimin e serbëve ne fshat për reth për të zvogluar izolimin e tyre.⁶⁸ Për t'ju përgjegjur kësaj kërkesë, qeveria italiane ka premtuar 3.5 milion Euro për rindërtimin e nentëdhjetë shtëpive ne fshatrat Sigë, Brestovik dhe Jevose.⁶⁹ Këto tri fshatra janë shkatruar plotësisht ne verë 1999, dhe ndodhen ne anën malore në dale te Pejës. Ky nuk është rajon bujqësore, fshatarët para luftës kanë punuar ne Pejë. Prandaj, nëqoftëse nuk përmisohet lirija e lëvizjes mbështetja ekonomike e procesit te kthimit mbetet e pazgjedhur.

Ky projekt ktimi fillimisht ka pasur një buxhet me të madhë dhe ka përfshirë një komponentë edhe për kthimin e minoriteteve jo serbe. Mirëpo, pasi që qeveria Italiane vendosi për t'i zvogëluar burimet e këti projekti, komponenta për minoritete u hoq. Të zhvendosurve Boshnjakë u është thënë se nuk do tu ipet ndihmë për rindërtim, kryesisht se janë nga komuniteti i gabuar.⁷⁰

Kuvendi Komunal i Pejës, e ka refuzuar ashpër këtë projekt duke miratuar një rezolut që thotë, "Ne e konsiderojmë hapin e tillle drejtë kthimit të Serbëve si tepër të nxituar". Përderisa rezoluta e ka pranuar të drejtën e kthimit edhe nevojën për t'i mbrojtur të drejtat mbi pronën, ata e kanë refuzuar projektin e kthimit të bazuar ne argumentin e rrejshëm se do te krijoj enklava te reja.⁷¹ Kryetari i

⁶³ Informatat e dhëna nga Zyra në Terren e UNHCR-së, nëntor 2002

⁶⁴ Intervistat e ICG-së me banorët e Bicajt, nëntor 2002

⁶⁵ Informatat e dhëna nga Zyra në Terren e UNHCR-së, nëntor 2002

⁶⁶ Informatat e dhëna nga Zyra në Terren e UNHCR-së, nëntor 2002

⁶⁷ Informatat e dhëna nga Zyra në Terren e UNHCR-së, nëntor 2002

⁶⁸ Disa përfaqësues serbë shprehen se nëse kthimet nuk zbatohen afër Pejës, banorët e Gorazhdecit mund të shkojnë. Intervista e ICG-së me Milorad Todoroviq, nëntor 2002.

⁶⁹ UNHCR, Raporti nga UNHCR në Kosovë për Komunitetin Drejtues të Komitetit të Përbashkët mbi Kthimin e Serbëve të Kosovës (JCR) 1 Prill – 31 Korrik 2001.

⁷⁰ Intervistat e ICG-së me aksionarë të ndryshëm, shtator, tetor dhe nëntor 2002

⁷¹ Komuna e Pejës, - Kërkes për Sqyrtimin e Rezolutës Zbatuese 1244 të Këshillit të Sigurimit, mbi kthimin e të

komunës ka pohuar se sërëbët "Do të kthehen dhe do të jenë nën urdhërat e drejtëpërdrejtja të Beogradit." Për të pavarësia është parakusht për t'u kthyer.⁷²

Fillimisht ky projekt do të financohej nga UNMIK-u i cili do t'ua mundësonte OJQ-ve dhe ndërmarrjeve private të marrin pjesë. UNHCR ne Beograd dhe Qendra për Koordinim, dhe UNMIK-u kanë qenë te angazhuara ne zgjedhjen e nëntëdhjetë familjeve që do te kthehen.⁷³ Mirëpo, donacioni i qeverise Italiane ka arritur me vonesë. Të hollat nuk kanë arritur as ne vjeshtë 2002, dhe rindërtimi i shtëpive është shtyer deri në vitin 2003.

Kapaciteti dhe ekspertiza e UNMIK-ut për implementimin e një projekti të tillë të kthimit është vënë në dyshim. Kritikët thonë se parat duhet të ishin kanalizuar nëpërmjet OJQ-ve që kanë ekspertizë teknike për kthim, si dhe degë të zyrav të tyre në Sërbë dhe Mal të Zi, që e lehtësojnë koordinimin. Zyra e UNMIK-ut për Kthim dhe komunitete është duke rishqurtuar këtë projekt për të siguruar që është në pajtim me strategjinë e saj të re e cila fokusohet në OJQ si partner implementues.

4. Bashkëjetesa ndërmjet komuniteteve

Ne Korrik 2001, UNHCR ka raportuar " Antarët e përsoneleit të një OJQ-je që punon drejtëpërdrejtë me UNHCR-ne jane ofenduar verbalisht dhe janë kërcënuar deri sa kanë qënë duke i vlerësuar nevojat për rindërtim të minoriteteve, pasi që janë informuar nga fshatarët Shqiptarë se rindërtimi për minoritete ua ka vjedhë të drejtën familjeve nevojtare shqipëtare dhe se shtëpitë e minoritarëve do të digjen posa te rindërtohen."⁷⁴

Situata është përmirsuar gradualisht dhe qëndrimet e shqipëtarëve dita ditës po bëhen më tolerante. KFOR-i po organizon pasdite tregu ne Pejë dhe

OJQ-të janë duke implementuar aktivitete ndëretnike me rininë si dhe disa projekte ekonomike mikro-kredish me qëllim te ndërtimit të urave midis bashksive. Mirëpo, kontakti midis bashkësisë shqiptare dhe sërëbe vazhdonë të mbetet tepër i kufizuar dhe të gjitha përpjekjet për të nxitur bashkjetesën paqësore duken ad hoc pa asnjë strategji të përgjithshme nga UNMIK-u për udhëzimin e këtyre kontakteve.⁷⁵ Nenad Radosavljevic, këshiltar i lartë i PSSP-se për kthime thot se një gjë e tillë është normale dhe se komunitete kanë jetuar ashtu edhe para lufte.⁷⁶

Edhe pse duhet bërë më shumë përpjekje për ty thyer pengesat midis këtyre komuniteteve, kjo duhet të jetë vetëm një pjesë e një përkushtimi afatgjatë dhe jo një iniciativë e vetmuar. Duhet te themelohet mardhënjet midis komunitetit që kthehet edhe rajonit që i pranon ata, dhe duhet të dërmerren iniciativa të shkallshkallshme në mënyrë që këto komunitete mos ta konsiderojne njëri-tjetrin armik.⁷⁷

Sidoqoftë, një incident që ndodhi me 10 Tetor e ilustron se sa e rrezikshme mbetet situata për minoritetet, veqanarisht për të kthyerit sërëb. Pensionistët sërëb kanë qenë duke shkuar ne ndërtesën komunale ne Pejë per t'u regjistruar për pensione. Pasi që kane arritur atje i ka pritë një turmë protestuesish. Situata është keqësuar dhe jane hedhur gurë dhe bomba benzini në autobusin e tyre. Policia më vonë ka arrestuar disa përsone që janë akuzuar për nxitjen e sulmit Asnjë pensioner sërëb nuk është lënduar dhe protestat kanë vazhduar për disa orë me radhë.

Dia faktorë e kanë shkaktuar protestën. Në vend të një grupi të vogël, 41 persona arritën para kuvendit komunal. Autobusi ka pasur tabelat e vjetra të regjistrimit të shkruar "Pec" në vend të tabelave të lëshuara nga UNMIK-u. Ka pastaj akuza se KFOR-i nuk ka vlerësuar rreziqet, pasi që dy

gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga kosaova – komuna jonë,- 11 shkurt 2002.

⁷² Takimi me Ali Lajqin, Kryetarin e Komunës së Pejës, shtator 2002

⁷³ Takimi me Zëvendës Administratorin e Komunës, Pejë, shtator 2002

⁷⁴ UNHCR, Raporti nga UNHCR në Kosovë për Komunitetin Drejtues të Komitetit të Përbashkët mbi Kthimin e Serbëve të Kosovës (JCR) 1 Prill – 31 Korrik 2001

⁷⁵ Zyra e Administratorit rajonal të UNMIK-ut ka Njësinë e Pajtimit. Përderisa Njësia është e angazhuar në disa aktivitete, si në përpjekjet për integrimin e spitalit rajonal, nuk kanë mundur ta definojnë strategjinë e tyre të përgjithshme

⁷⁶ Intervista e ICG-së me Nenad Radosavljeviq, tetor 2002

⁷⁷ Intervista e ICG-së me Përfaqësuesin e UNHCR-së në Terren, nëntor 2002

procese zgjedhore kanë ndodhur atë ditë në qendër të Pejës.⁷⁸

5. Bashkësitë e lëna pas dore

Ndihma e thimit nuk është bërë me të drejtë të barabartë në këtë rajon. Nevojat për rindërtim të romëve, hashkalinjëve, boshnjakëve dhe egjyptianëve të kthyer si dhe të atyre që nuk kanë ikur nuk janë adresuar fare. Prej 124 familjeve serbe që anë kërkuar ndihmë për rindërtim, 116 kanë përfutuar nga projektet për rindërtim. Nga romët, egjyptianët, boshnjakët dhe hashkainjët, 216 familje kanë kërkuar ndihmë rindërtimi dhe vetëm 22 familje kanë përfutuar nga to. Kjo pabarazi ekziston megjithë faktin se 40 % të të kthyerve janë nga komunitetet joserbe.⁷⁹

Përderis të kthyerit serbë kanë pasur të drejtë për ndihmën që e kanë përfutuar një babarazi e tillë dëshmon se sa është i plitizuar procesi i kthimit, dhe një pabarazi të bashkësis donatore. Sidoqoftë ndihma e këtyre komuniteteve është e komplikuar, pasi që personat nga këto komunitete janë të pabarazuar dhe nuk janë të vetëdijshëm për kanalet institucionale të ndihmave.⁸⁰ Të drejtat mbi pronën e shumë nga personat e këtyre komunitetev janë të komplikuar për shkak të mungesës së dokumenteve të duhura. Për më tepër romët janë tregtarë dhe banorë të qytetve, dhe kërkojnë më shumë liri lëvizjeje.⁸¹ Përderisa 10% e ndihmës komunale për rindërtim për minoritete është realizuar në disa komuna të rajoni, shumica e tillë nuk është e mjaftueshme duke pasur parasysh nevojat e mëdha të minoriteteve.

B. GJILAN: KTHIMET E QËNDRUESHME

Rajoni i Gjilanit në pjesën jug-lindore të krahinës, përfshinë komunat e Gjilanit, Vitisë, Kamenicës,

Novobërdës, Kacanikut, Ferizajit dhe Shtërpces. Vazhdon të jetë një nga rajonet etnikisht më të përziera në Kosovë, dhe kthimet e në këtë rajon kanë qenë bukur të suksesshme.⁸²

Lufta në këtë rajon ka qenë relativisht e lehtë krahasuar me Pejën dhe disa vrojtues thonë se ky është një nga arsyet kryesore pse procesi i kthimit është aq i avancuar në këtë rajon. Por periudha e pasluftës është shënuar me sulme kundër minoriteteve. Për ndryshim nga Peja, shumë pjestarë të komunitetit serb nuk janë tërhequr me AJ-në dhe si rezultat kanë qenë në shënjestër të sulmeve.

Derisa vetëm një shtëpi është shkatërruar deri në hyrjen e KFOR-it në Kosovë, deri në tetor 1999, 280 shtëpi janë shkatërruar, 150 të serbëve dhe 130 të familjeve rome.⁸³

Pershkak të pozitës, kufirit me Sërbinë jugore dhe Maqedoninë, Gjilani kohëve të fundit ka dëshmuar rreziqe të sigurimit. Në vitin 2001 jostabiliteti në luginën e Preshevës dhe Republika e Maqedonisë e kanë kërcënuar sigurinë në këtë rajon. UQPMB-ja është rebeluar në Sërbinë jugore dhe UQK-ja

⁸² Shumica e komunave në rajonin e Gjilanit ka ende popullata të konsiderueshme minoritetesh dhe rënia në popullatat minoritare nga 1991 nuk ka qenë aq dramatik si në rajonin e Pejës. Gjilan: 1991 – 19 370 serbë (18.7 përqind I popullsisë së përgjithshme) dhe 3477 romë (3.4 përqind); figurat e tanishme vlerësojnë 13479 serbë (13.1 përqind) dhe 400 romë (1.1 përqind); Kamenicë: 1991 - 12930 serbë (25%) 573 romë (0.85%). Tani ka 12 000 serbë (20.5 %) dhe 500 romë (1.1 %); Novobërdë: 1991 - 2676 serbë (31 %). Figurat e tanishme vlerësojnë 1600 serbë (41.5 %) - por këto vlerësime mund të jenë të ulëta, pasi që partitë serbe e kanë fituar shumicën në zgjedhjet komunale. Viti - 1991, 5259 serbë (9 %), 782 kroatë (1.4%), dhe 253 romë (0.4%). Vlerësimet e tanishme janë 3586 serbë (7.7%) dhe 90 romë (0.2%). popullsia e Shtërpces ka mbetur kryesisht e njëjtë dhe pse ka disa zona ku ka një numër të konsiderueshëm të të zhvendosurve shqiptarë. Më 1991 popullata përfshinte 8303 serbë (66%), 4125 shqiptarë (32.8%) dhe 101 romë, përderisa ta ni gjenden 9099 serbë (66.7%) 4500 shqiptarë (33%), dhe 34 romë. Mirëpo serbët kryesisht i kanë lëshuar komunat e Ferizajit dhe Kacanikut. Në ferizaj në vitin 1991 ka pasur 8191 serbë (8.6%) dhe 2081 romë (2.2%) Figurat e tanishme janë: 7serbë dhe 3338 romë (2.3%) Në Kacanik më 1991ka pasur 220 serbë dhe 306 romë. Të gjithë kanë ikur. Shih Dosjet Komunale të OSBE-së. Gusht 2002

⁸³ Misioni I Verifikimit në Kosovë, OSCE, Kosova e Parë dhe si Estdhtë Thënë për Të. II Raporti mbi të Drejtat e Njeriut I Misionit të OSBE-së në Kosovë, Qershor –Tetor 1999

⁷⁸ Intervistat e ICG-së me Zyrën e UNHCR-së në Terren , Pejë edhe Administratorin rajonal të UNMIK-ut, tetor 2002

⁷⁹ UNHCR/UNMIK, Informimi I Donatorëve lidhur me Kthimet, 11 tetor 2002

⁸⁰ Intervista e ICG-së me përfaqësuesin e UNHCR-së, nëntor 2002

⁸¹ Intervista e ICG-së me përfaqësuesin e UNHCR-së, nëntor 2002

(Ushtria Qilirimtare Kombëtare) në Maqedoni e kanë përdorur këtë rajon si fushë regrutimi dhe si pikë transiti për armatim. Luftimet në rajonin përreth e kanë shkaktuar një valë refugjatësh shqipëtarë dhe të zhvendosurve që të kthehen në këtë rajon-Afër 8000 të zhvendosur e kanë lëshuar luginën e Preshevës dhe 65000 të tjerë kanë ardhur nga Maqedonia.⁸⁴

Këto luftime kanë pasur ndikim serioz në gjendjen e minoriteteve në këtë rajon. Gjatë pranverës dhe verës të vitit 2001 " një ngritje e dhunës etnikisht të motivuar gjatë Prillit dhe Majit të hershëm (kryesisht që i ka prkur sërbi të Kosovës në disa komuna) ka shkaktuar destabilizim dhe jousiguri në komunitetin sërbi në përgjithsi.⁸⁵ Lista e sulmeve kundër minoriteteve është e gjatë dhe ka përfshirë vjedhjen e bagëtisë dhe makinerisë bujqësore. Sulmin me predha në disa shtëpi sërbe vrasja e një të riu, vrasja e një plaku sërbi, vrasja e një sërbi që është kthyer për të përfunduar shitjen e shtëpisë së tij, dhe një sër sulmesh tjera që kanë vrarë tre sërbi.⁸⁶ Për më tepër sërbi nuk kanë mundur të udhëtojnë më lirisht për në Sërbi nëpër luginën e Preshevës, gjë që e ka kufizuar edhe më tej lirinë e lëvizjes.⁸⁷ Bashkësia Nderkombëtare është friguar se vala e refugjatëve do të rezultojë në marrjen e shtëpive të minoritarëve, dhe do të risë garën për ndihma dhe shërbime.⁸⁸

Duke marrë parasysh ambientin e rrezikshëm suksesin në nxitjen e kthimeve vetëm pas një viti është për t'u befusuar. Disa faktorë kanë ndikuar për një sukses të tillë: përpjekjet e KFOR-it dhe të policisë për të normalizuar gjendjen e sigurisë; klima politike lidhur me kthimet; dhe menyra e implementimit të kthimeve.

1. Normalizimi i gjendjes më të madhe së Sigurisë

KFOR-i dhe Policija e UNMIK-ut kanë ndërmarur aktivitete specifike për të normalizuar gjendjen e

sigurisë dhe për të krijuar një klimë të përshtatshme për kthim. Janë bërë përpjekje për ndërtimin e një tregu multietnik në Gjilan, për të ritur lirinë e lëvizjes si dhe për të mundësuar shfrytëzimin e kujdesit shëndetsorë. Edhe pse jo pa rreziqe këto aktivitete janë ndërmarur me planifikim të konsiderueshëm edhe me një vlerësim thelbësorë të rreziqeve.⁸⁹ Me zvogëlimin e ngadalshëm të KFOR-it ky sektorë gjithashtu shquhet për punën me komunitetet lokale për ta qarur këtë rajon drejt normalizimit. Për shembull para terheqjes së përcjelljes së sigurimit të shërbimit të autobusave për minoritete KFOR-i u'a ka lëshuar në video kasetë udhëtarëve për t'u'a demonstruar mundësitë e KFOR-it në përcjelljen e autobusit nëpërmjet patrullimit ajrorë edhe pse nuk ka pasur përcjellje direkte.

Edhe pse rajoni nuk është pa probleme këto iniciativa gradualisht kanë dhënë fryte. "Në Gjilan lëvizja e shtuar ka qënë si rezultat i drjtëpërdrejt i përpjekjeve ndërkombëtare për të siguruar transport special për t'i sjellur Sërbi nga rajonet përreth në qytet për shitblirje ditën e tregut tri herë në javë. Fillimisht KFOR-i ka qënë prezent në numër të madhë gjatë periudhës së ndërtimit të mirbesimit mirëpo prezenca ushtarë në mënyrë graduale dhe të suksesshme është zvogëluar.⁹⁰

Policija ka qënë dhe vazhdonë të jetë element i rëndësishëm në procesin e normalizimit. Ata kanë qënë aktiv, në sigurimin e mbrojtjes gjatë ditëve të tregut multietnik dhe i kanë përcjellur pjestarët e komuniteteve minoritare për në qendrat shëndetsore dhe spitale. Për më tepër patrullat multietnike janë pesë e rëndësishme e shërbimit policorë të Kosovës (KPS), Sërbi përbëjnë afër 8.5% të policëve. Vullneti i policisë për t'i marrur këto përgjegjësi dhe suksesi i këtyre iniciativave është një mësim për rëndësinë e politikës së komunitetit për krijimin e kushteve të kthimit.

Disa komentatorë frigohen se rajoni mund të shohë ngritje në dhunën e motivuar etnikisht me rritjen e numrit të të kthyerve.⁹¹ Procesi i kthimit

⁸⁴ UNMIK/UNHCR, Informimi i donatorëve, 11 tetor 2002

⁸⁵ UNHCR, Raporti nga UNHCR në Kosovë për Komunitetin Drejtues të Komitetit të Përbashkët mbi Kthimin e Serbëve të Kosovës (JCR) 1 Prill - 31 Korrik 2001

⁸⁶ Ibid

⁸⁷ Ibid

⁸⁸ Ibid

⁸⁹ Intervista e ICG-së me KFOR-in, Sektori i Shteteve të Bashkuara, tetor 2002

⁹⁰ UNHCR/OSBE. Vlerësimi i Nëntë, shtator 2001 - prill 2002

⁹¹ Intervista me Zyrtarin eUNMIK-ut 2002

koincidonë në reduktimin e planifikuar të trupave të KFOR-it do të jetë shume me rëndësi që policija ta kete kapacitetin e ruajtjes së sigurisë derisa KFOR-i reduktohet.⁹²

2. Klima Politike e Kthimit

Për ndyshim nga ajoni i Pejës klima politike ne Gjilan ka qenë e përshtatshme për t'u kthyer. Kryetari i komunës së Gjilanit ka treguar një përkushtim për gjendjen e komuniteteve minoritare dhe aktivisht e ka mbështetur kthimin e tyre. Komuna paguan për përcjelljen e punëtoreve serb dhe e ka mbështetur renovimin e shkollave ne rajonet minoritare.⁹³

Nënkryetari i komunës së Gjilanit është përfaqësues i komunitetit serb dhe me gjithë diferencat punon me komunën për t'i sjellur shërbimet komunale në dobi të komuniteteve dhe për t'i eliminuar strukturat paralele. Ai i ka deklaruar ICG-se se vetëm një vit më heret klima e tanishme e integritit dhe kthimit nuk do të mund të merrej me mend. Mirëpo, ai thot se problemit i tanishëm është mungesa e burimeve. " Më parë kur kishte shumë OJQ, serbët nuk mund ta shfrytëzonin ndihmë e tyre për arsye sigurie. Tani kur serbët mund ta shfrytëzojnë ndihmen OJQ-t janë të pakta dhe ka shumë më pak burime."⁹⁴

Ky rajon prap se prapë nuk është pa zona të vështira kthimi. Përderisa liderët në disa komuna i kanë mbështetur kthimet në disa komuna tjera si Ferizaj dhe Kaçanik ka qenë më vështirë. Por, grupet punonjëse komunale të kthimit janë tani në veprim nëpër gjithë rajonin dhe UNMIK-u me UHCR-ne janë duke përdorur këto grupe pune si mekanizëm për t'i nxitur komunitat të bashkëpunojnë. Për më tepër në zgjedhjet lokale te Tetorit 2002 partitë politike serbe e kanë fituar shumicën ne kuvendin komunal të dy komunave, Novobërd dhe Shtërpce. Kjo duhet të ketë ndikim në peocetin e kthimit.

3. Procesi i Kthimit

Megjithë gjendjen e tensionuar të sigurisë kthimi spontan ka filluar në verë 2001 në grupe të vogla. Njerëzit janë kthyer në zonat rurale në Gjilan, Novobërd, Kamenicë dhe Viti. Disa nga këto kthime janë bërë ne zona te përziera.⁹⁵ UNHCR-ja dhe partneret tjerë implimentues të financuar nga qeveria Amerikane i kanë shfrytëzuar keto kthime spontane për ta lehtësuar kthimin e autorizuar në këto fshatra. Aty ku ka qenë e mundur projektet kanë përfshirë të gjitha kombësitë dhe kanë filluar me një dialog të gjërë me bashkësinë pranuese.⁹⁶

Përderisa implimentimi preciz ndryshon nga fshati ne fshat, të gjitha kthimet e organizuara në këtë rajon përbehen nga keto elemente:

- Të zhvendosurit trgojne interes për t'u kthyer, OJQ-ja implimentuese ndermer dialog dhe masa për sendertimin e mirëbesimit në mes komunitetit që i pranon dhe atij kthyes si dhe bënë vizita informative dhe të mbikqyrjes.
- Fillohet me projektet për rindërtim;
- KFOR-i së bashku me UNHCR-në dhe partnerët imlementues merret me vlerësimin e rreziqeve dhe vepronë siq e kërkonë nevoja;
- Mbështeten projektet për sigurimin e të ardhurave si Serat, dyqanet e vogla dhe furrat e bukës; dhe,
- Bënë përpjekje për sigurimin e shërbimeve publike. Inkurajohet shfrytëzimi i qendrava të përbashkta shendetsore dhe shkollave.⁹⁷

Mekanizmat kordinues në mes UNMIK-ut KFOR-it dhe partnerëve implementue janë shumë të fortë në këtë rajon. UNHCR së bashku me KFOR-in ka zhvilluar një mekanizëm për vlerësimin e rreziqeve në fshatrat e kthimit.⁹⁸ UNMIK-u është siguruar se të gjitha grupet punuese të nivelit

⁹² Intervista e ICG-së me KFOR-in Amerikan, nëntor 2002

⁹³ Intervista me Lutfi Hazirin, Kryetarin e Komunës së Gjilanit, tetor 2002

⁹⁴ Intervista e ICG-së me Sasha Xhorxheviq, nën-kryetarin e Komunës së Gjilanit, tetor 2002

⁹⁵ Këto komunitete përfshijnë Makresshin e Poshtëm/Sipërm, Leshtarin, dhe Koloninë e Vjetër. Në vitin 2002, UNHCR ka intervnuar për të përkrahur kthimin spontan të shqiptarëve në Biitininë e Poshtme në Shtërpce.

⁹⁶ Intervista e ICG-së me Zyrën e UNHCR-së në Terren, ttor 2002

⁹⁷ Intervista e ICG-së me UNHCR-në, Komitetin Amerikan për Refugjatë (ARC) dhe KFOR-in, tetor 2002.

⁹⁸ Intervista e ICG-së me Zyrën e UNHCR-së në terren, tetor 2002

komunal janë në funksionim gjtë kthimeve dhe është siguruar pjesmarrja e zyrtarëve komunal.

Në fshatin Makresh që gjindet në dalje të Gjilanit disa serbë janë kthyer me vetëiniciativë në verë 2001. Ata i kanë përmendur kushtet në Serbi si arsye kryesore për kthimin e tyre. Ky është një fshat i përzier, me pjesën serbe që gjendet përgjatë rrugës kryesore dhe atë shqiptare që gjendet në afërsi. Shumica e njerëzve kanë qenë të zhvendosur gjatë konfliktit - shqiptarët kanë jetuar në Gjilan, për shkak se shtëpitë e tyre kryesisht kanë qenë të shkatërruara dhe serbët kishin ikur për Serbi. Për të shfrytëzuar kthimin spontan të disa serbëve, UNHCR-ja e ka kordinuar një kthim të organizuar të serbëve dhe shqiptarëve. Fshati tani përbëhet nga 43 familje serbe dhe 12 shqiptre.

Projekti për kthim të organizuar ka filluar me një dialog në mes të komuniteteve. Pastaj ka filluar rindërtimi i shtëpive, me 34 shtëpi të ndrequra apo rindërtuara të serbëve dhe dymbëdhjetë shtëpi të renovuara të shqiptarëve. Jane mbështetur projektet për sigurimin e të ardhurave, duke përfshirë serat, dhënjën e bagëtisë dhe hapjen e një dyçani të vogël. Edhe pse komuniteti serb është ankuar se nuk ka lopë për qumesht dhe djathë, aa përgjithësisht kanë qenë të kënaqur me bashkësinë ndërkombëtare. Pastaj komunitetet kanë rënë dakord të shfrytëzojnë së bashku klinikën shëndetësore përderisa shkolla mbetet e ndarë, fëmijët shqiptarë udhëtojnë disa kilometra në fshatin fqj. Në këtë fshat nuk ka kurrëfarë prezence të forcave të sigurimit.

Stara Kolinja, një fshat historikminierash që gjendet në komunën e Novobërdes ka përjetuar një proces të tillë, por për dallim nga Makreshi, shqiptarët dhe serbët jetojnë krah për krah. UNMIK-u dhe UNHCR e kanë mbështetur rindërtimin e shtëpive të të dy komuniteteve dhe e kanë hapur një furrë për të siguruar mjete yë vogla materiale. Në kohën ur ICG i ka vizituar ata, situata në këtë fshat ishte normale, pa prezencë të forcave të sigurimit dhe shqiptarët u dilnin në ndihmë të kthyerve serbë në rindërtimin e shtëpive të tyre. Të gjithë anëtarët e komunitetit ishin të brengosur për mundësinë e punësimit, dhe një familje serbe priste me padurim që bija e tyre të punësohej në KPS.

Edhe pse numri i të kthyerve është i vogël fsht për fshat, së bashku ata araqesin një arritje të konsiderueshme. Ky proces është edhe më i qëndrueshëm shikuar nga pikëvështrimi ekonomik dhe ai i sigurisë, për shkak të metodës së kthimit.

Por modeli i kthimit në Gjilan nuk është pa të meta. Disa përfaqësues serbë thonë se fondet amerikane duhet të ishin shfrytëzuar për mbështetjen e kthimit në shkallë më të madhe.⁹⁹ Kritikët tjerë thonë se kthimi i tillë individual është i shtrenjtë dhe nuk është i përshtatshëm për të gjithë të kthyerit.

4. Komunitetet e Anashkaluara

Megjithë gjendjen ppaksa të përmirësuar në Pejë, trendi për anashkalimin e komuniteteve joserbe sa i përket ndihmës së dhënë vazhdon në raonin e Gjilanit. Prj 64 familjeve erbe sa kanë kërkuar ndihmë për rindërtim, vetëm shtatë prej tyre nuk iu është dhënë. nga 98 familje shqiptare, rome dhe hashkalinjë që kanë kërkuar ndihmë, vetëm 28 familje kanë marrur ndihmën e duhur.¹⁰⁰

UNHCR pohon se një nga çështjet problematike me të cilën ballafaqohen minoritetet joserbe është mungesa e strehimit në qendrat urbane. Përderisa kjo nuk bëhet numri i të kthyerve romë dhe hashkalinje do të mbetet i vogël.¹⁰¹

C. KRAHASIMI I DY RAJONEVE

Këto dy rajone dallojnë dramatikisht. Peja ka qenë rajoni më i goditur nga lufta, me luftime të rënda në mes UCK-së dhe UJ-së, aktiviteteve të ënda të paramilitarëve dhe shkalës së lartë të dëmtimit të pronës. Shumica e serbëve të Pejës janë tërhequr neqershor të vitit 1999 bashkë me UJ-në, dhe tani për tani rajoni ka shumë pak minoritarë. Gjilani mbetet njëra ndër rajonet më të përziera në Kosovë. Edhe pse rajoni i Gjilanit nuk ka përjetuar shumë luftime në vitet 1998, 1999, periudh e pasluftës ka dëshmuar një seri sulmesh kundër minoriteteve që ka vazhduar edhe gjatë vitit 2001.

⁹⁹ Interista e ICG-së me Nenad Radosavljevic, tetor 2002

¹⁰⁰ UNMIK/UNHCR, Informimi i Donatorëve, 11 tetor 2002

¹⁰¹ Intervista e ICG-së me UNHCR-në, nëntor 2002

Mirëpo këto diferenca nuk mund ta shpjegojnë suksesin relativ të kthimeve në Gjilan, vecanërisht duke pasur parasyshë situatën e atjeshme të vitit 2001. Përderisa e drejta për tu kthyer në të gjitha rajonet është e padiskutueshme, shembulli i Gjilanit tregon se mënyra e kthimit ka ndikim në mardhëniet ndërmjet komuniteteve, kushtet e të kthyerve dhe qëndrueshmërinë e procesit.

Anaizimi i kthimeve në cdo rajon nuk mund të bëhet në këtë raport, secili i ka rrethanat dhe cilësitë e veta. Rezultatet e këtij krahasimi nuk mund të zbatohen plotësisht në cdo rajon, mirëpo mësimet e këtyre mund të mirren nga këto dy procese kthimi. Këto vërejtje e kanë dirigjuar ristrukturimin e strategjisë së UNMIK-ut për kthim.

1. Parimet Ndërkombëtare të Kthimit

Modeli i Gjilanit është më së shumti në përputhje me parimet ndërkombëtare të kthimit. Kthimi ka qenë dinjitoz dhe kthimet e organizuara kanë qenë vazhdimësi e kthimeve sponatane. Kushtet për bashkëjetje paqësore janë plotësuar me dialog para kthimit, vendosjes së projekteve për sigurimi e të ardhurave dhe shfrytëzimin e shërbimeve publike paralelisht me rindërtimin e shtëpive. Të gjitha komunitetet kanë përfituar nga këto projekte.

Në rajonin e Pejës, vetëm disa komunitete serbe kanë mbetur dhe siguria si dhe kushtet materiale nuk janë të përshtatshme për kthim spontan. Prandaj nëse serbët duan të kthehen, mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare dhe me mbrojtjen e KFOR-it ngase të kthyerit nuk kanë liri lëvizjeje. Nëse kthimi realizohet në kushte të tilla, është me rëndësi esenciale të krijohen kushtet për bashkëjetje paqësore me fqinjët. Edhe pas më shumë se një viti të kthimit në Osojan enklava mbetet e ruajtur rëndë nga KFOR-i dhe banorët kanë pak kontakt me fqinjët shqiptarë dhe nuk kanë as vullnet të fillojnë kontaktin me ta.¹⁰²

Kthimi i organizuar tregon përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare se kushtet si siguria dhe ato ekonomike - që ndikojnë në numrin e të kthyerve -

do të realizohen. Sic e shohim në rastin e Bicajit, çështjet si liria e lëvizjes dhe mundësia e shfrytëzimit të shërbimeve publike si dhe dialogu me komunitetin që i pranon janë adresuar vetëm pas kthimit. Përderisa të kthyerit duhet të jenë realistë në kërkesat e tyre - ata kthehen në kushte të vështira - nevojat themelore duhet të sigurohen para kthimit.

2. Siguria Logjike

Kthimi në ambientet ku kërkohen kushte masive sigurimi, nga vetë natyra varen nga prezenca e vashduar ushtarake. Nëse kthimi mbështetet në shkallë të lartë në mbrojtjen fizike, reduktimi i KFOR-it do të ndikojë në gjendjen e zonave të kthimit dhe mund të rrezikojë përpjekjet e UNMIK-ut për kthime të mëtutjeshme. Prandaj përgadidjet paraprake duhet të bëhen para zvogelimit të prezencës së KFOR-it dhe për normalizimin e gjendjes së sigurisë.

Në rajonin e Gjilanit, KFOR-i fillon me vlerësimin e rreziqeve në zonat e kthimit dhe me mbrojtjen serioze kur arrijnë të kthyerit. Me kalimin e kohës ata paraqiten më pak dhe ia lënë policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës (KPS) me njësitet multi etnike përgjegjësinë e ruajtjes së sigurisë. Përderisa KPS-ja multi-etnike patrollon në disa zona të Pejës, KFOR-i është kritikuar për tolerancë tepër të ulët ndaj rreziqeve duke përdorur kështu prezencë të tepërt për të mbrojtur minoritetet.¹⁰³

3. Parakushtet: Dialogu dhe Ekonomia

Sëndërtimi i tolerancës midis komuniteteve pranuese dhe të ardhura është qelësi i suksesit për kthim të ëndrueshëm.¹⁰⁴ Përqendrimi i kthimeve të serbëve në disa lokacione të kufizuara në Pejë ka marrur shumë mund dhe mjete. Pasi qeshumica e serbëve kishin ikur, kthimi nuk ka mundur të bazohet komunitetet ekzistuese dhe kthimet spontane si në rajonin e Gjilanit. Shembulli i Osojanit ku s'ka pasur dialog para kthimit nuk duhet të përsëritet. Përderisa zyrja regjionale e

¹⁰² Intervista e ICG-së me banorët e Luginës së Osojanit, nëntor 2002

¹⁰³ Intervista e ICG-së me OJQ-në "Concern" që vepron në rajonin e Pejës, tetor 2002.

¹⁰⁴ UNHCR/OSBE, Vlerësimi i Nëntë, shtator 2001 - prill 2002

UNMIK-ut në Pejë ka njësinë e pajtimit, është koncentruar në aktivitetet pa kthimit të serbëve dhe i mungon një vizion i përgjishëm apo strategji për thyerjen graduale të barrierave.

Në Gjilan cdo kthim është trajtuar si i përzier.¹⁰⁵ Lehtësimi i dialogut në Gjilan e ka përgaditur komunitetin pritës për kthimet, i ka shqyrtuar kërkesat e të kthyerve dhe i ka vënë bazat për haat e vegjës drejt bashkëjetesës paqësore në nivelin e komuniteteve.

Kthimi nuk është proces i thjeshtë, prandaj investimet duhet të përfshijnë edhe sigurimin e mundësive të punësimit dhe shërbimet funksionale publike. Përderisa sukcesi i disa projekteve për sigurimin e të ardhurave mbetet të shihet, OJQ-të e kanë kuptuar se janë element kyç i procesit të kthimit. Dhe në disa rajone kanë qenë të sukseshme përpjekjet për të integruar shërbimet publike, si shkollat dhe ambulancat.

OHQ-të që punojnë në rajonin e Gjilanit dhe komunikojnë me komunitetet pranuese. Jo ua mundëson dhenien e informatave të zhvendosurve mbi kushtet në Kosovë, dhe për ti siguruar të zhvendosurit se procesi i seleksionimit për marrjen e ndihmave është i dretë dhe se respektohet dhe mbrohet kthimi me vetëdëshirë, organizon vizita paraprake të vendit të kthimit si dhe ndërmerr bisedime para kthimit. Pasiqë OJQ-të që vepronë në rajonin e Pejës nuk kanë përfaqësi përtej kufirit, atëherë nuk e kanë këtë përparësi.

4. Bashkëpunimi: Koordinimi

Në rajonin e Gjilanit, UNMIK, UNHCR, KFOR-i dhe OJQ-të që punojnë në kthime, takohen një herë në muja në nivelin rajonal, funksionojnë të gjithat grupet punonjëse dhe i përfshijnë përfaqësuesit komunalë. Përfaqësuesit organizatave të ndryshme të kthimit takohen më shpesh si pjesë e seancave të tyre strategjike. UNMIK-u dhe UNHCR-ja janë udhëheqësit kryesorë në rajon.

Rajoni i Pejës i ka të regjistruara të gjitha mekanizmat e koordinimit, dhe është shembull në themelimin e njësisë për pajtim dhe njësisë për

projekte. Mirëpo sipas anëtarëve, takimet koordinuese uk janë të rregullta dhe përvoja dhe ekspertiza e pjesëmarrësve kryesorë, si UNHCR, nuk është përfshirë gjithmonë. Për më tepër, vetë krijimi i njësisë projektuese dhe për pajtim e ka ndryshuar rolin e zyrës rajonale të UNMIK-ut prej mbikqyrësit në aplikues, rol për të cilin nuk e kanë mundësinë dhe ekspertizën teknike. Sic përshkruhet më poshtë, Zyra e UNMIK-ut ër Kthime dhe Komunitete e ka pranuar se e ka kuptuar këtë çështje, dhe se është duke e adresuar nëpërmjet implementimit të kthimit nëpërmjet OJQ-ve dhe nxjerrjes së doracakut për kthime.

5. Mbështetja politike pa Politizim

Procesi i kthimeve kërkon mbështetjen politike të liderëve kosovarë pa e politizuar çështjen. Në rajonin e Pejës, secili komunitet e pranon kthimin si të drejtë absolute për vetveten derisa e kushtëzon kthimin e të tjerëve. Autoritetet e të gjitha niveleve komunale nuk kanë qenë shumë miqësore sa i përket kthimeve, përderisa Kuvendi Komunal i Pejës hapur e ka shprehur ariqësinë e vet ndaj mundësisë së kthimeve të organizuara në komunën e tyre. Ata e trajtojnë zhvendosjen dhe kthimin si pazarllëk politik për pavarësi e sjo si çështje humanitare apo çështje e të drejtave njerëzore.

Assesi nuk mund të nënvleftësohet rëndësia e mbështetjes që i ka dhënë kryetari i komunës së Gjilanit procesit të kthimit. Për më tepër strategjia e di sa lidereve krahinor sic përmendet më poshtë në detaje ka qenë gjithashtu një përkrahje. Njerëzit tani duhet ta lënë retorikën dhe të ndërmarrin masa konkrete për mbështetjen e kthimeve.

6. Sfidat e vazhdueshme në të Dy Rajone

Mbështetja e minoriteteve joserbe vuan nga mungesa e vëmendjes dhe përkrahjes ë të dy rajonet. Shume kthime spontane, kryesisht të grupeve minoritare joserbe janë bërë pa ndihmën ndërkombëtare. Shumica jetojnë me farefisn apo me miqtë, ose strehohen në shtëpi dhe banesa të braktisura. Pasi që këto kthime janë spontane, shfrytëzimi i ndihmës për rindërtim është problematik. Mundësia e UNMIK-ut dhe UNHCR-së që t'iu përgjegjet

¹⁰⁵ Intervista e ICG-së me UNHCR-në dhe Komitetin Amerikan për Refugjatë, tetor 2002.

kërkesave individuale për ndihmë kufizohet nga mungesa e fondeve.¹⁰⁶

Për më tepër shpesh është përmendur pamundësia e Drejtorisë për Pronë dhe Strehim që t'iu përgjigjet kërkesave si dhe t'i kryej ndërtimet paraqet pengesë për kthim. Të zhvendosurit duket se nuk anë të vetëdijshëm ër procesin e kërkesave për strehim, dhe ata që i kanë bërë kërkesat janë shumë të shqetësuar për shkak të kohës që merr për ti kryer ato.

Qëndrueshmëria e procesit të kthimit mbetet nën dyshim, vecanërisht për ata që nu mund të shfrytëzojnë tokat e punës. Të gjithë të kthyerit e kanë ërmendur pamundësinë e punësimit si gjënë më brengosëse. Mungesa e progresit të kthimeve në zonat urbane është problematike në të gjitha rajonet e Kosovës. Disa të zhvendosur pohojnë se procesi i kthimit do të jetë i suksesshem vetëm atëherë kur njerëzit mund të kthehen në zonat urbane dhe të mund të gjejnë vende pune.¹⁰⁷

VI. KUSHTET GJENERALE PËR KTHIMIN NË TËRË KOSOVËN

Rritja e vogël e kthimeve në vitin 2002 është rezultat i përmirësimit të kushteve për komunitetet minoritare si dhe i iniciativave specifike të përkrahjes së kthimeve nga bashkësia ndërkombëtare. Kushtet kryesore janë: siguria, strehimi, ekonomia, inkuadrimi në shërbimet publike dh pranimi nga komuniteti shumice. Ndërkohë që vlerësimet në regjionin e Pejës dhe gjilanit tregojnë se është vështirë të gjeneralizohet, kushtet janë përmirësuar. Mirëpo të kthyerit si dhe komunitetet e minoritetve ekzistuese ende përbalen me pengesa serioze që duhet të adresohen.

A. SIGURIA, SIGURIMI DHE LIRIA E LËVIZJES

Sigurimi është sfida kryesore për minoritetet në Kosovë. Situata është përmirësuar dukshëm që nga vera e vitit 1999, dhe liria e lëvizjes është shumë më e madhe. Edhe pse jo si indikator ekskluziv, rënia e vrasjeve në Kosovë është ilustruese. në vitin 200 kanë ndodhur 245 vrasje, 40 prej të cilëve ishin serbë, numër shumë i madh duke pasur parasyshë proporcionin në popullatën e përgjithshme. Në vitin 2001ky numër ka rënë në 136, me vetëm 30 viktimat serbe. më 2002, deri në fillim të dhjetorit, kanë ndodhur 64 vrasje, përfshirë edhe kater serbë. në ri nga to viktimat janë vrarë nga serbë tjerë për problem personale. Në rastin e fundit motivi nuk është i ditur.¹⁰⁸

Poashtu në njëfar mase rënia e vrasjeve ndëretnike mund ti mbështetet krijimit të enklavave të mbrojtura dhe ikjes substnciale të minoriteteve nga krahina, kushtet e përditshme jetësore që dita ditës janë përmirësuar që nga viti 2000 në mënyrë drastike, edhe pse nuk është pikë e përshtatshme krahasimi. Liria e lëvizjes është shumë e madhe vecanërisht në vendet si Gjilani dhe Prizreni, dhe është e zakonshme që nëpër rrugë të dëgjohet të folurit në gjuhën serbe. Shumë nga këto permirësime kanë të bëjnë me përpjekjet e policisë

¹⁰⁶ Agjencioni Evropian për Rindërtim ka dhënë ndihmën e vet - fonde për rindërtim për njëqind shtëpi - vecanërisht për minoritetet jo-serbe.

¹⁰⁷ Intervistat eICG-së me të kthyerit, tetor dhe nëntor 2002

¹⁰⁸ Intervista e ICG-së me Zëdhënësin e Policisë, Barry Fletcher, dhjetor 2002

së UNMIK-ut dhe KFOR-it (shih më poshtë) për të krijuar një ambient të sigurt.

Mirëpo UNHCRja tërheq vërejtjen:

Në rrethanat ku minoritetet ballafaqohen me kërcënime dhe probleme të vazhdueshme dhe ku periudhat e qetësisë mund të ndërprehen në mënyrë të ashpër nga sulmet serioze të motivuara etnikisht që nganjëherë rezultojnë në humbje jete, një shoqëri e sigurt kërkon më shumë për tu themeluar plotësisht. Për kunder rënis së vazhdueshme në numrin dhe frekuencën e sulmeve seriozefizike, situata përgjithësisht karakterizohet nga tensionet ndëretnike, dhuna dhe shkalla e lartë e mosndëshkimit.¹⁰⁹

Prandaj siguria e minoriteteve mbetet e brishtë, sic vihet re nga disa incidente të mëhershme në Pejë, Viti dhe Klinë me të kthyrin. Në Pejë një autobus i të kthyerve që aplikonin për pensionet e tyre u pritën me protestë që zgjati dy orë dhe përfunduan me hedhjen e bombave të gazit. Ndërkohë që asnjë i kthyer nu është lënduar janë bërë disa arrestime, dhe kjo ka ndikuar në besimin e serbëve në ambientin e siguruar.¹¹⁰ Gjatë vizitës "shko dhe shiko" në Viti makinat janë gjuajtur me gurë nga fëmijet.¹¹¹ Në një fshat të Klinës një i kthyer serb është sulmuar vetëm disa javë pas kthyerjes në shtëpi.¹¹² Më 17 nëntor, menjëherë pas largimit të forcave të KFOR-it dhe një ditë para vizitës së Sekretarit të Përgjithshëm të KB në Kosovë, në Istog janë hedhur në ajër dy kisha ortodokse. Askush nuk është lënduar.

Si reagim për shkak të kushteve të vështira ekzistuese të sigurisë, më 1999 KFOR-i themelon postblloqe (garda të pozicionuara) afër komuniteteve serbe dhe organizon përcjelljen e udhëtimit të minoriteteve nëpër tërë Kosovën, duke përfshirë edhe fëmijët shkollorë. KFOR-i ka filluar t'i tërheqë këto pozicione për tri arsye. E para, për

shkak të resionit nga UNHCR dhe UNMIK-u për normalizimin e ambientit duke mos u vërejtur prezenca e tyre rreth komuniteteve të minoritetit. E dyta, punët e bëra marrin në numër të konsiderueshëm ushtarësh dhe disa argumentojnë se nuk ishin përdorje efikase e burimeve, më pak patrulla lëvizëse mund ta ruajnë më mirë sigurinë e përgjithshme. Dhe tre, popujt kontribues të NATO-s kanë vendosur ta zgvoqojnë kontributin e trupave dhe KFOR-i është i detyruar të gjej vend për zvogëlimin e numrit të ushtarëve. Strategjia e lëvizjes ka filluar në verë 2002 dhe janë ndeshur me rezistencën e disa komuniteteve serbe. Disa familje refuzojnë ti dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë pa përcjelljen e KFOR-it, duke pasur frike se fëmijët e tyre mund të sulmohen. Në rastet kur ka siguria është e kërcënuar, policia ka marrur përsipër përcjelljen e këtyre nxënësve.

Shume thonë se komunitetet minoritare e ekzagjerojnë rrezikun e sigurisë. Ky përcëptim është ndezur nga mediat serbe që dokumentojnë për së afërmi çdo incident të sigurisë dhe në disa raste duke fabrikuar sulme kundër serbëve.¹¹³ Krimet me motive etnike janë kryer në mes viteve 1999 dhe 2001, shumica e të cilave nuk janë ndëshkuar. kuptohet se kjo e ka dobësuar mirëbesimin e popullatës minoritare në proceset gjyqësore dhe ambientin e sigurt. Për sehembull dy sulmet me të rënda kundër serbëve të Kosovës kurrë nuk janë zgjidhur. Më 23 korrik 1999 në Grace, një fshat i vogël në jug të Prishtinës, 14 fshatarë serbë janë vrarë me AK-47. Asnjë akuzë nuk është ngritur për krim. Më 16 shkurt 2001, është sumuar konvoji i shoqëruar nga KFOR-i i autobusëve civilë nga Nishi për në Graçanicë. 11 janë vrarë dhe 40 anë lënduar. Përkundër tri arrestimeve individuale, një nga të cilët ka ikur ng baza ushtarake amerikane, Camp Bondsteel, personat janë liruar në mungesë të fakteve.¹¹⁴ Policia dhe sistemi gjyqësor janë duke e rritur kapacitetin e tyre për spatriimin e të gjitha krimeve, por do të marri kohë për ta fituar mirëbesimin dhe sigurinë e këtyre komuniteteve.

¹⁰⁹ UNHCR/OSBE, Vlerësimi i Nëntë, Shtator 2001 - Prill 2002

¹¹⁰ Agence France-Press, "Përleshja e policisë së UNMIK-ut me shqiptarët etnikë në Kosovën përendimore," 10 tetor 2002

¹¹¹ Shih Kosova Drejtëpërdrejt, "Germova nën Orën Policore Pas Incidentit," 12 nëntor 2002.

¹¹² Intervista e ICG-së me të kthyerit serbë dhe me UNHCR-në, nëntor 2002

¹¹³ Intervista e ICG-së me Zëdhënësin e Policisë së UNMIK-ut, Derrick Chappell dhe Barry Fletcher, dhjetor 2002

¹¹⁴ Shih Raportin Ballkanik të ICG-së Nr.134, Gjetja e Balansit, Shkalla e Drejtësisë në Kosovë, 12 shtator 2002

Prandaj shue komunitete minoritare kanë zhvilluar vartësi psikologjike ndaj KFOR-it. Masat si si dhënia falas e tabelave të lejes së Kosovës" lidhja hekurudhore e publikuar pak ë parë prej Fushë Kosove deri në Beograd e rritë lirinë e lëvizjes. Mospranimi i Serbisë i këtyre tabelave e komplikon udhëtimin për në Serbi. Mirëpo të kthyerit duhet të kenë vetëbesim që ti shfrytëzojnë këto mundësi.

B. STREHIMI

Pasiqë të zhvendosurit i braktisën shtëpitë e tyre, shumica e pronës është marrur oe zënë, dhe pjesa tjetër është dëmtuar apo shkatërruar. Drejtoria për Strehim dhe Pronë (HDP) është krijuar mu për të ofruaj një mekanizëm të pavarur legal ndërkombëtarisht të mbikqyrur për ti zgjidhur kontestet e pronës për banim dhe për ta mbrojtur statusin juridik të pronarëve të pronave të braktisura. Komisioni për të Drejta Banesore dhe Pronësore (HPCC) është një trup kuazi-gjyqësor i HDP-së i cilivendosë për të drejtat e tilla. HDP dhe HDCC kanë jurisdiksion ti zgjidhin këto kërkesa:

- Individët të cilët e kanë humbur të drejtën e tyre mbi pasurinë menjëherë pas 23 marsit 1989 në bazë të legjislacionit diskriminues. Deri në tetor kjo përbën 3.6 % të të gjitha kërkesave.
- Pronarët që kanë bërë transaksione joformale por jotëdhunshme të pasurisë së patudshme pas vitit 1989 dhe dëshirojnë ti legalizojnë këto transaksione. Këto përbëjnë 1.6 % të kërkesave.
- Kërkesat e të zhvendosurveqë kanë poseduar pronë banimi para 24 marsit 1999, dhe që e kanë braktisur këtë pronë pa vetëdëshirë dhe nuk e kanë më në posedim. Këto përbëjnë 94.8 % të kërkesave.
- Deri më 20 tetor 2002 numri i përgjithshëm i kërkesave të ngritura është 21 360, derisa vetëm 835 sosh janë zgjidhur.¹¹⁵

HDP-j e nënvlerëson rëndësinë e procesit të kthimit duke theksuar se qëllimi i tij kryesor është vendimi që në dis raste i lehtëson kushtet e kthimit

në terren.¹¹⁶ Mirëpo me gjithë rëndësinë e ceshtjeve pronësore për proesin e kthimit dhe faktin se 95% t kërkesave jnanë të bëra nga të zhvendosurit, funksionimi i suksesshëm i HDP-së është esencial për kthimet.¹¹⁷ Në kthimin ë paradokohshem të familjeve Hashkalite në rajonin e Vushtrrisë, HDP ka treguar mundësinë konstruktive në procesin e kthimit duke e përdorur mandatin¹¹⁸ e vet për strehimimin e romëve të kthyer.

Por HDP vuan nga disa mangësi që ndikojnë në procesin e kthimit. Organizata është kritikuar për procesin e ngadalshëm të vendimeve të kërkesave dhe për ështëimin që të ndër marrë bile edhe një nxjerrje në disa pjesë jashtë Kosovës. Bordi Vendimprurës takohet vetëm një herë në dy muaj gjë që seriozisht e kufizon efikasitetin e procesit. Disa serbë të zemëruar me natyrën e ngadalshme të procesit e kanë akuzuar HDP-në se vepron më shumë si agjensi e patundshmërisë - që lehtëson shitjen e pronës në vend të kthimit.¹¹⁹

Duke pasur parasyshë mungesën e fondeve, HDP ka marrur vendim ti drejtojë mjetet e veta në pranimin e kërkesave sesa zgjidhjen e tyre. Kjo ua a mundësuar njerëzve ngritjen e kërkesave, duke i futur ato në regjistër zyrtar. Pasiq mjetet kanë mugar për procesimin e kërkesave, zgjidhja e tyre është ngadalësuar. Për ti procesuar këto kërkesa si duhet, HDP thotë se duhen më shumë fonde për ti përgaditur rastet për vendim.¹²⁰ Donatorët nuk duan ti shpërndajnë fondet pa parë shenjat e nj procesi më efikas.

Informimi i kmomiteteve minoritare mbi mekanizmat e kërkesave të HDP-së është gjithashtu i kufizuar. "Jashtë Kosovës të zhvendosurit në serbi kanë vetëm njohuri elementare mbi përgjegjësitë e HDP-së për tu marrur me pronën e zaptuar ose për qasjen e mekanizmave për kthimin legal dhe riposedimin e

¹¹⁶ Intervista e ICG-së me HPD-në

¹¹⁷ UNHCR/OSBE Vlerësimi i Nëntë, Shtator 2001 - Prill 2002

¹¹⁸ HDP-ja mund të shfrytëzojë pronën e braktisur për ti strehuar personat pa zgjidhje tjetër strehimi - rastet humanitare

¹¹⁹ Intervista e ICG-së me përfaqësuesit serbë, nëntor 2002

¹²⁰ Intervista e ICG-së me HPD-në, tetor 2002

¹¹⁵ Drejtoria për Strehim dhe Pronë, Statistika, 29 shtator 2002".

pronës".¹²¹ Njoftimi në Mal të Zi dhe Maqedoni është poashtu problematik. Një fushatë informative është ndërmarrur në Kosovë dhe Serbi në vjeshtë 2002, dhe UNMIK-u dhe HDP shpresojnë se ka ofrua më shumë informata për të zhvendosurit dhe për publikun në përgjithësi mbi HDP-në dhe procesin e ngritjes së kërkesave. Aplikuesit kanë afat deri më qershor të vitit 2003 për kërkesat e tyre.

Romët dhe hashkalinjtë kanë probleme të vecanta të pronësisë ër arsye se shumë prej tyre bokumenta për shtpitë në të cilat kanë jetuar. Kjo komplikon edhe më tej punën delikate të titullit të pronësisë. Për më tepër as një zyre e HDP-së nuk vepron në Maqedoni që e komplikon qasjen në mekanizmat për kërkesa për refugjatët e atjeshëm.

Mungesa e ndihmës për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara është paraqitur si pengesë për kthim. Nga fondet e ndara për rindërtim nga UNMIK-u për secilën komunë, 10% duhet të ndahen për minoritetet. Por në vitin 2000, minoritetet kanë marrur vetëm 2% të ndihmave për rindërtim, derisa në vitin 2001, minoritetet kanë marrur 4.2 % nga shuma e përgjithshme. Sipas UNHCR-së shumica e Komisioneve Komunale për Strehim kanë dështuar në shpërndarjen e ndihmave të minoritarëve në proporcion me nevojat e tyre.¹²² Për më tepër ata duhet të jenë fizikisht prezent para se t'iu ipet ndihma për rindërtimin e shtëpie të tyre.¹²³

Një strukturë nxitëse duhet të vendoset në mënyrë që komunat t'i rindëtojnë shtëpitë e minoritarëve dhe të kthyren. Shuma prej 10 % nuk është e mjaftueshme; komunitet e konsiderojnë atë si kulm në vend të shkallës minimale të fondeve prandaj, duhet të merren masa të rrepta, komunat duhet të dënohen për mosdhënien e pjesës së nevojshme të fondeve për komunitetet minoritare. Shuma e ndihmës së ndarë për minoritetet duhet ta relektojë vlerësimin e saktë të nevojave në terren.

¹²¹ UNHCR/OSBE Vlerësimi i Nëntë, Shtator 2001 - Prill 2002

¹²² Ibid

¹²³ Intervistat e ICG-së me administratorët komunalë të UNMIK-ut dhe UNHCR-së dhe me OJQ-të që punojnë në çështjen e kthimit

C. EKONOMIA

Të gjithë banorët e Kosovës janë të brengosur për ekonominë dhe të kthyerit e të gjitha komuniteteve që i ka vizituar ICG i kanë përmendur mungesën e punësimit dhe të mundësive ekonomike. Shkalla e artë e papunësisë është fenomen i gjithmbarhëm në Kosovë. Edhe pse ekonomia është përmirësuar dukshëm që nga viti 1999, ky përmirësim kryesisht është rezultat i kthimit të diasporë kosovare dhe ndihmave ndërkombëtare.¹²⁴ Ekonomia mbetet e dobët dhe shumë e varur nga renia substanciale e ndihmave të huaja që priten në vitin 2003 dhe 2004. Të gjitha komunitetet në Kosovë vuajnë nga shkalla e lartë e papunësisë që vlerësohet të jetë mes 29 deri 57%.¹²⁵

Te minoritetet, shkalla e papunësisë është edhe më e lartë - afër 85% janë të papunësuar. Mundësitë e punësimit janë të kufizuara nga mungesa e lirisë së lëvizjes dhe nga diskriminimi sistematik i tregut të punësimit. Vetëm nëse të kthyerit kanë tokë pune kanë mundësi punësimi në vendet e pakta të sektorit publik.

Edhe pse shumicë e minoritarëve janë të papunë, ata që punojnë 70% janë të punësuar në setorin publik. Rregullorja që e rregullon shërbimincivil thot se "regrutimi në të gjitha nivelet do të reflektoje karakterin multi-etnik të Kosovës dhe nevojën për përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve të Kosovës."¹²⁶ UNMIK-u kërkon që 8 deri në 18 % të vendeve të plotësohen nga minoritarët. Edhe pse kjo mbetet një objektivë e përgjithshme, ende nuk janë caktuar pozitat në

¹²⁴ Prodhimi i Përgjithshëm Vendor i Kosovës vlerësohet të jetë rritur prej 1.4 miliardë euro në 2 miliardë euro për vitin 2002., Zyra Evropiane, Raporti i Progresit për Kosovë, 25 tetor 2002. Mungesa e mundësive ekonomike në Kosovë është faktor i rëndësishëm shtytës në vendosjen për ta lëshuar Kosovën pasi që minoritetet dhe shqiptarët kërkojnë mundësinë për punësim në vendet tjera

¹²⁵ Zyra Evropiane, Raporti I Progresit në Kosovë, 25 tetor 2002

¹²⁶ Shih Rregulloren Nr. 2001/36, "Mbi Shërbimin Civil në Kosovë," 22 dhjetor 2001. Rregullorja mbi Degën Ekzutive të qeverisë gjithashtu e thekson këtë parim duke u shprehur "Përfaqësimi i jo-shumicës në përbërjen e Shërbimit Civil në të gjitha nivelet do të jetë proporcional me përfaqësimin e komunitetit jo-shumicë në Kuvend." Rregullorja Nr. 2001/19. "Mbi Qeverinë në Kosovë," 13 shtator 2001

secilën ministri për përfaqësuesit e komuniteteve minoritare. Në niveelin qëndror minoritetet tani për tani kanë më pak se 8% të pozitive ë ministri, dhe përqindje më të ulët të pozitive në komunat e përziera, dhe më pak se 1% të vendeve të punës në shërbimet publike.¹²⁷

Barrierat për mundësi punësimi kuptohet se ekzistojnë. Për shembull, vendet e lra të punës nuk përkthehen në gjuhë të tjera dhe nuk shpallen në zonat minoritare.¹²⁸ Për të përmirësuar këtë, UNMIK-u i publikon ato në mediat serbe dhe dhe punëtorët e komunitetit lokal bisedojnë drejtpërdrejtë me udhëheqësit e komuniteteve lidhur me mundësitë e punësimit.

Të kthyerit e intervistuar nga ICG kanë qenë të vetëdijshëmvetëm për vendet e punës në KPC dhe kanë thënë se nuk janë të informuar për vendet në shërbimin civil, qoftë ato të nivelit qëndror apo komunal. Ka pastaj probleme brendapërbrenda komuniteteve minoritare, personat mund të ndëshkohen pse punonën UNMIK, dhe disa nuk besojnë se ia vlen të punosh për PISG-un pasi që rrogat janë shumë të vogla.¹²⁹

Bashkimi i komuniteteve shumicë dhe pakicë rreth interesave të përbashkëta ekonomike mund të jetë mënyrë efikase për ndërtimin e urave mes komuniteteve si dhe arritjen e levërdive për të dy palët. Mirëpo kjo qasje nuk është përdorur sa duhet në Kosovë. Shumica e projekteve nuk i kanë inkorporuar qëllimet e përbashkëta ndër-etnike dhe vetëm disa donatorë e kanë përdorur kushtëzimin - zonat e përziera, projektet duhet t'i përfshijnë minoritetet për tu mbështetur. Një biznesmen nga Prishtina është për diskriminim pozitiv - nëse kompanitë kanë punëtorë multi-etnikë, do të kenë avantazh ndaj konkurrenës tjerë. Nëse kjo aplikohet, kjo qasje do të nxiste punësimin e minoritarëve dhe do t'ua siguronte biznesmenëve një shkallë sigurie. Nëse biznesi i poseduar nga shqiptarët do të qortohej për punësimin e minoritarëve, ata mund të mbrohen duke përmendur nevojën

përavantazh ndaj konkurrentëve.¹³⁰ Me rënien e nivelit të ndihmave në Kosovë,¹³¹ do të bëhet edhe më i rëndësishëm përdorimi i mekanizmave inovativë për tu siguruar se ndihmat ekonomike ndërtojnë ura midis komuniteteve.

D. SHËRBIMET PUBLIKE

Lokacionet e të kthyerve shpesh nuk kanë infrastrukturë adekuate, si rrugë, dhe shërbimet si kanalizim, ujë, rrymë dhe telefon, që ndikon në dëshirën e njerëzve të kthehn. Qasja në shërbimet publike mbetet problematike për shumë komunitete minoritare që vec jetojnë në Kosovë, pasi që diskriminimi i heshtur e parapinë qasjen dhe cilësinë e këtyre shërbimeve.¹³² Përderisa të gjitha komunitetet duhet ta kuptojnë nevojën për pagesën e llogarive,¹³³ shumica shqiptare duhet ta pranojë përgjegjësinë që vie me kontrollin e këtyr shërbimeve.

Shërbimet shëndetësore janë të një rëndësie të vecantë për komunitetet që kthehen. Edhe pse shumica e komuniteteve i kanë mjett e përkujdesit primar shëndetësor qasja ndaj atyre seondare është e penguar dhe serbët nuk kanë shërbime terciare në Kosovë - atyre iu duhet të shkojnë në spital në Mitrovicën veriore ose në Serbi. Shumica e shërbimeve primare të komuniteteve serbe raportojnë dhe janë të paguara nga Beogradi e jo nga UNMIK-u, dhe shumë njerëz shkojnë në Mitrovicën veriore apo në Serbi për përkujdesje spitalore.

¹³⁰ Lance Johnston, pronar i Balkan International, firmë sigurie që vepron në Prishtinë, ka kërkuar nga UNMIK-u ta pranojë këtë strategji. Disa persona me të cilët ka biseduar ICG mendojnë se masat e tilla afirmative nuk funksionojnë në Kosovë dhe do të shkaktojnë reagim. Mirëpo ICG-ja rekomandon se mekanizmat e tilla inovativë duhet të testohen në disa rajone

¹³¹ Të gjithë donatorët janë duk i reduktuar fondet e tyre. Agensioni Evropian për rindërtim (EAR) njëherë ka qenë donatori më i madh bilateral në Kosovë. Nga viti 1999-2001, EAR ka dhënë 689 milion euro, dhe në vitin 2002, 135 milionë euro. EARda ta zvoglojë buxhetin e ve dramatikisht në vitin 2003 - edhe pse nuk është publikuar ende, uxheti i EAR-së do të bie deri në 49 milionë euro

¹³² UNHCR/OSBE, Vlerësimi i Nëntë, Shtator 2001 - Prill 2002

¹³³ Intervista e ICG-së me Zëvendës Administratorin Komunal, Pejë, shtator 2002

¹²⁷ Intervista e ICG-së me Zyrtarin e UNMIK-ut, nëntor 2002

¹²⁸ UNHCR/OSBE, Vlerësimi i Nëntë, Shtator 2001 - Prill 2002

¹²⁹ Intervista e ICG-së me Zyrtarin e UNMIK-ut, nëntor 2002

Mungesa e lirisë së lëvizjes gjithashtu e pengon funksionimin e sistemit efektiv arsimor të minoritarëve të të gjitha niveleve. Shërbimet që ekzistojnë janë nën autoritetin e Beogradit dhe janë në marrëdhënie të tendosura me UNMIK-un. Fëmijët romë dhe hashkalinje kanë probleme të ndryshme shkollimi, varësisht prej asaj se a flasin shqip apo serbisht. Në disa zona shkollat janë të integruara me ndrrime dhe ka plane për fillimin e klasave të përziera të lëndëve si arti dhe edukata fizike.¹³⁴

Duhet bërë më tepër për tu siguruar se bashkësia ndërkombëtare lë pas vete një sistem të integruar shëndetësor dhe arsimor në Kosovë.¹³⁵ Disa të kthyer me të cilët ka bisedur ICG i kanë lënë fëmijët e tyre në Serbi për shkak të mungësës së shërbimeve arsimore në fshatrat e tyre.¹³⁶ Por përpjekjet për integrimin e këtyre shërbimeve (me turne në bazë të diferencave gjuhësore) nuk janë pa vështirësi. Cështje të vazhdueshme janë se a do të mbesin mësuesit në listat e pagav të UNMIK-ut dhe Beogradit, ku do të vendosen shkollat dhe influenca e Beogradit mbi këto institucione.

UNMIK-u duhet të ushtrojë autoritetin e vet në zonat minoritare për sigurimin e këtyre shërbimeve dhe për parandalimin e strukturave paralele nga Beogradi. Për të siguruar barazi në shërbimet publike, do të nevojitet roli udhëheqës i UNMIK-ut dhe PISG-ut si dhe krijimi nxitësve për shpërblimin e departamenteve publike që i plotësojnë nevojat e të gjitha komuniteteve.

E. PRANIMI NGA ANA E KOMUNITETIT SHUMICË

Shumica e projekteve të kthimit si dhe vizitat "shko dhe shiko" të të kthyerve potencialë, janë duke vazhduar pa incidente sigurie. Mirëpo komuniteti shumicë vazhdon të mos jetë entuziastë lidhur me procesin e kthimit. Edhe pse nuk mund të ketë prakushtë për kthim, qëndrim i komunitetit shumicë do të jetë kritik për qëndrueshmërinë e procesit të kthimit. Liderët politikë shqiptarë dhe liderët e shoqërisë civile i përmendin disa cështje

problematike kur përmendin cështjen e kthimit, përfshirë edhe fatin e të zhdukurve; frigën se do të kthehen kriminelët që kanë bërë krime, akuzat se ata që kthehen vetëm duan ta shesin pronën e tyre dhe nevojën që të kthyerit ta pranojnë "realitetin e ri" në Kosovë. Edhe pse komuniteti pranues nuk duhet ta ketë mundësinë e vetos ndaj përpjekjeve të kthimit këto brenga duhet të merren parasyshtë dhe të adresohen nëpërmjet bisedave para kthimit me UNHCR-në dhe UNMIK-un.

Në shumë zona kthimi, fati i të zhdukurve më 1998 dhe 1999 mbetet i pandrikuar. Për fatin e 3400 shqiptarëve askush nuk është përgjigjur.¹³⁷ Përderisa UNMIK-u dhe anëtarët e qeverisë publikisht kanë deklaruar se të zhdukurit mund të jenë të vdeur, familjet e të zhdukurve thonë se UNMIK-u nuk është duke e marrur seriozisht këtë punë. Ata fuqimisht besojnë se disa prej tyre mund të jenë të gjallë - besim - i ngajllur nga "porositë" nga personat që thonë se i kanë parë disa të zhdukur dhe thonë se ata janë duke u "mbajtur" në burgje të fshehta në Serbi.¹³⁸ Këto mesazhe ka shumë të ngjarë se janë të rrejshme dhe përdoren për të përfituar para ng vuajtjet e njerëzve.

Fati i të zhdukurve është problem për të gjitha komunitetet. Afër 1300 joshqiptarë janë të zhduar, shumë prej tyre janë zhdukur pas ardhjes së UNMIK-ut dhe KFOR-it.¹³⁹ Përderisa ndikon në pranueshmërinë e kthimit nga shqiptarët, ka gjithashtu ndikim të rëndësishëm në besimin e të kthyerve në gjendjen e sigurisë.

Shqiptarët gjithashtu frigohen se kriminelët e dyshuar të luftës do të kthehen. Kjo frikë është e arsyeshme kur dihet se disa qytetarë kanë qenë të kycur në njësitë paramilitare që kanë ndermarrur sulme kundër shqiptarëve. Por personat janë të pafajshme nëse nuk vërtetohet një gjë e tillë. Sistemi gjyqësor sado që të jetë i dobët, funksionon në Kosovë.¹⁴⁰ Të dyshuarit për krime mund dhe duhet t'i dorëzohen sistemit gjyqësor.

¹³⁴ UNHCR/OSBE, Vlerësimi i Nëntë, Shtator 2001 - Prill 2002

¹³⁵ Ibid

¹³⁶ Intervista e ICG-së në fshatin Bicaj, nëntor 2002

¹³⁷ Figura nga Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi

¹³⁸ Intervista e ICG-së me zyrtarë të ndryshëm komunal, shtator dhe tetor 2002

¹³⁹ Shifra nga Departamenti i Drejtësisë, nëntor 2002

¹⁴⁰ Shih Raportin e ICG-së për Ballkan Nr. 134, Gjetja e Balansit: Shkalla e Drejtësisë në Kosovë, 12 shtator 2002

Ka shuë akuza se të kthyerit marrin ndihmën ndërkombëtare për ti shitur më vonë pronat e tyre. Prandaj shumë shqiptarë thonë se ndihma e dhënë serbëve për rindërtim është "shpenzim i kotë i parave".¹⁴¹ Nëse procesi i kthimit menaxhohet si duhet ata që janë vërtetë të përkushtuar të qëndrojnë do të ndihmohen. Mirëpo njerëzit kanë të drejtë mbi pronën e tyre dhe nuk ka asnjë metodë për vlerësimin e qëllimeve të të kthyerve. Nuk do të ishte etike nëse bashkësia ndërkombëtare ta paragjykojë ndimën e vet me rrezikun se njerëzit do ti shesin shtëpitë e veta.¹⁴²

Politikanët dhe liderët e shoqërisë civile theksojnë se të kthyerit duhet ta kuptojnë se kjo është një Kosovë e re ku qveria serbe nuk pyetet më. Për më tepër ata thonë se duhet të pranohen padrejtësitë e kryera nga autoritetet serbe.

Përderisa të gjitha palët duhet ta pranojnë se situata në Kosovë ka ndryshuar, duhet pranuar shkeljet e mëparshme të të drejtave të njeriut, dhe të ndermerren masa për ti dënuar kryesit e tyre, qëndrimi i komunitetit shumicë ndaj të kthyerve paraqet pengesë për procesin e kthimit. Edhe pse shqiptarët i akuzojnë serbët për mbajtjen e shërbimeve paraele, ekziston një diskriminim në dhënien e përfitimeve publike. Ata nuk shohin asnjë dobi nga kthimet dhe kanë friqe se të kthyerit do ti marrin burimet e kufizuara.¹⁴³ Këto qëndrime janë si trashëgimi nga dekada e kaluar e diskriminimit, dhe tensione historike në mes shqiptarëve dhe serbëve cysht para të 1990-ave. Mirëpo shqiptarët shumë shejt e kanë shprehur para ndërkombëtarëve vizionin e Kosovës multi-etnike. Për fat të keq veprat e tyre shpesh nuk e mbështezin këtë vizion.

¹⁴¹ Intervistat e ICG-së me përfaqësuesit shqiptarë, shtator dhe tetor 2002

¹⁴² Bashkësia ndërkombëtare i jep prioritet dhënies së ndihmave për ata që duan të qëndrojnë - nëse i kthyeri shpreh dëshirën për ta shitur pronën, nuk ka shansa të marrë ndihmë për rindërtim

¹⁴³ Intervista e ICG-së me një zyrtar të UNMIK-ut, Gjilan, nëntor 2002

VII. MUNDËSIMI I KTHIMIT: POLICIA DHE LOJTARËT NË PROCESIN E KTHIMIT

Bashkë me ligjin dhe rregullin, privatizimi dhe sjellja e sundimit të UNMIK-ut në Mitrovicën veriore, kthimi i të zhvendosurve është një nga prioritetet e UNMIK-ut progresi i kthimeve është një nga "standardet" që duhet të realizohen para fillimit të bisedave lidhur me statusin final. UNMIK-u e ka hartuar një seri të pikave lidhur me kthimet:

- krijimi i kushteve për kthime të sigurt dhe të qëndrueshme dhe riintegrimi;
- të gjithë të zhvendosurit dhe refugjatët duhet ti kenë informatat eduhura për të vendosur për tu kthyer;
- duhet të fillojnë kthimet në zonat urbane; dhe
- duhet të caktohet buxheti adekuat nga PISG-u për kthime dhe riintegrim.

Për të demonstruar përkushtimin ndaj këtyre ërkesave, entitetet lokale duhet ti ndermarrin aktivitetet që vijnë:

- të ndermarrin mbështetje aktive për kthime dhe riintegrim, për shembull të organizojnë aktivitetet "shko dhe shiko";
- liderët kryesorë shqiptarë duhet të marrin pjesë në vizitat "shko dhe informo" për të zhvendosurit në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni; dhe
- PISG-u duhet ta ndajë një pjesë të buxhetit të vet për kthime spontane dhe për aktivitetet riintegruese.¹⁴⁴

Mundësia e UNMIK-ut për ti plotësuar këto caqe do të ndikohet jo vetëm nga kushtet në terren, por edhe nga mënyra e kordinimit dhe menaxhimit të procesit të kthimit. projektet e deritanishme janë karakterizuar nga një mori e vepruesve që kanë shkaktuar konfuzion dhe qasje të ndryshme në rajonet e ndryshme. Sic përshkruhet më lartë, koordinimi në rajonin e kthimit është ad hoc dhe varet nga personalitetet në vend të mekanizmave të themeluar.

¹⁴⁴ UNMIK, Standardet para Statusit, Maj 2002.

Pastaj caqet janë të drejtuara kah nivelet qendrore të qeverisjes se kah niveli komunal që ka pasur më shumë ndikim në proceset e kthimit. Komuna duhet të sigurojë se një pjesë e drejtë nga finansimii buxhetit komunal ndahet për komunitetet minoritare, dhe aty ku ka nevojë, UNMIK-u duhet të jetë i ashpër me këto komuna.

A. VEPRUESIT KRYESORË DHE QËNDRIMET E TYRE

1. UNMIK: Zyra për Kthime dhe Komunitete (ORC)

Me nënshkrimin e "Dokumentit të përbashkët" më 5 nëntor 2001, UNMIK-u e ka marrur përsipër procesin e kthimit: "Nderimi i të drejtës së patjetërsueshme të thimit të personave të zhvendosur dhe të refugjitëve në shtëpitë e tyre, UNMIK-u do ta themelojë si prioritet ZYrën për Kthime nën mbikqyrjen direkte të PSSP-së, që vepron si tru operativ kordinues për vazhdimin e procesit duke përfshirë sugjerimin e një plani të ri për kthime gjatë viteve 2002-2003."¹⁴⁵

Sirezultat, UNMIKU e ka themeluar ZYrën për kthim dhe KOMUNITETET (ORC) në dhjetor 2001. Mandati i sajë është ti theksojë direktivat për procesin e kthimit, dhënien e këllillave strategjike për çështje të ndryshme PSSP-së, koordinimi rajonal dhe në nivelin komunal të grupve punuese. Të bisedojë me qeverinë serbe dhe të lidhet me komunitetin donator me qëllim të promovimit të procesit të kthimit dhe përmirësimit të kushteve për komunitetet që vec jetojnë në Kosovë.¹⁴⁶

Në maj 2002 ORC ka lëshuar komunikatën e parë të UNMIK-ut për çështjet e rikthimit. Përvec theksimit të nevojës për kthim vulnetar, k sjellur tri parime kryesore për rikthim në Kosovë.

E para, procesi i kthimit duhet të jetë i qëndrueshëm të drejtat individuale për shërbime publike dhe sociale përfshijnë qasjen në arsim, përkujdesje shëndetësore, sigurim social dhe duhet të mbrohen shërbimet publike. UNMIK-u dhe

KFOR-i do të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar lirinë e lëvizjes.

E dyta, prioritet do të jipet të kthyerve në vendin e origjinës. ORC ka refuzuar rielokimin potencial të minoriteteve si jokontribuese për qëllimet afatgjate të Kosovës multi-etnike. Rikthimet e organizuara do të diskutohen në nivelet lokale me grupet e punës të nivelit komunal dhe rajonal që i raportojnë Njësisë së Punëve të Kthimit. Për kthimet e tilla, duhet të jipet ndihma adekuate për rindërtim për të rindërtuar shtëpitë e dëmtuara dhe të shkatërruara. Duhet të shqyrtohen të drejtat individuale të pronës private, duke përfshirë masat përmirësuese për pengesat joligjore nëpërmjet Drejtorise për Pronë dhe Strehim.

Dhe së treti nuk mund të ketë kurrëfar kushtesh qoftë politike apo tjera për kthim nga komunitetet pranuese. Kthimet nuk mund të varen nga zgjidhja e çështjeve politike, sociale apo humanitare. Kthimi i një komuniteti nuk mund të kushtëzohet nga kthimi reciprok i ndonjë komuniteti tjetër. Dhe nuk mund të vendoset asnjë afat për të drejtën e kthimit.¹⁴⁷

Zyra e Kthimeve dhe Komuniteteve tani është në udhëheqjen e re. Peggy Hicks, veteran i Bosnës, ka arritur në fillim të gushtit për të riaktivizuar ORC-në dhe për ta mbushur me qrtësi dhe energji të re. Shumë shpejt ajo është angazhuar në procesin e ristrukturimit për të mësuar nga proceset e kthimit brenda rajonve të ndryshme - vecanërisht në Gjilan dhe Pejë. Ky rishqyrtim i ka sjellur këto konkluzë.¹⁴⁸

Nevojë për Qartësinë e Roleve. Veprimtarët e ndryshëm që kanë përdorur politia të ndryshme në rjonet e ndryshme të Kosovës e kanë karakterizuar procesin e kthimit. pas procesit të rikonstruktimit, trupi i vetëm për vendosjen e strategjive do të jetë ORC-ja dhe zyra do të jetë vendtakimi qndror për donatorët dhe OJQ-të për procesin e kthimit.

Qasja nga Poshtë-Lartë. Përgjegjësia për mbikqyrjen e projekteve të kthimit në disa raste ka qenë nga lartë-poshtë. Për të shmangur politizimin,

¹⁴⁵ "Pajtimi për Bashkëpunim Midis Jugosllavisë dhe UNMIK-ut" 5 nëntor 2001

¹⁴⁶ takimi i ICG-së me ORC-në, gusht 2002

¹⁴⁷ Zyra për Kthime dhe Komunitete, E Drejt për Kthim të Qëndrueshëm: Kornizë Konceptuale, 17 maj 2002

¹⁴⁸ Intervista e ICG-së me Peggy Hicks, Drejtor i Zyrës për Kthime dhe Komunitete, tetor 2002

planifikimi i kthimeve duhet të fillojë në nivelin komunal bër ti bashuar kërkesat dhe mundësitë e kthimit. Për të siguruar një mekanizëm për këtë qasje nga poshtë-lartë, ORC-ja do të inkurajojë partnerët implementues nga OJQ-ë përtej kufirit si dhe do të bëjë kycjen e të zhvendosurve në grupet punuese komunale. Për të rritur pranueshmërinë e komunitetit shumicë ndaj procesit të kthimit, ORC planifikon të angazhohet persona me përgjegjësi dhe mdat në nivelin qëndror, komunal dhe të komunitetit.

Qëndrueshmëria. Sic është e qartë në rajonin e Pejës e ardhmja afatgjate e procesit të kthimit është diskutabile. Për ta rritur qëndrueshmërinë e procesit të kthimeve, ORC do ta inkurajojë zhvillimin e projekteve shumë-sektorëshe të kthimit që përfshijnë strehimin, infrastrukturën, qasjen në shërbimet publike, sigurimin e të ardhurave, bisediet ndër-etnike dhe implementimin e ktiviteteve për komunitetet.

Standardet Profesionale: Për të siguruar plotësimin e standardve të kthimit dhe qasjen konsistente në tërë Kosovën, UNMIK-u është duke zhvilluar një direktivë masash të njëpasnjëshme për kthim bashkë me një doracak për kthime të qëndrueshme. Doracaku ofron parametrat për rritjen e koordinimit dhe zvogëlimin e rrezikut e diferencave të rëndësishme regjionale. Sipas doracakut, kthimet fillojnë me identifikimin e nevojave të kthimit, përgaditjen e konceptit të tij, rivlerësimet regjionale dhe vendosja e shpërndarjes së listës së Projektit Prioritar donatorë. ¹⁴⁹ ORC nuk i mbështetë projektet implementuese të UNMIK-ut dhe prandaj i inkurajon OJQ-të me ekspertizë të duhur në rajonin e kthimeve të veprojnë si partnerë implementues. ¹⁵⁰

ORC-ja i raporton drejtpërdrejtë PSSP-së. Përderisa personeli është kryesisht ndërkombëtar, është edhe një përfaqësues serb, Nenad Radosavljevic si këshiltar i lart. Përpjekjet për regrutimin e profesionistëve tjerë lokalë janë në rrugë e sipër, dhe ky regrutimi da ta sigurojë përfaqësimin e shqiptarëve dhe pakicave jo-serbe në ORC.

2. UNHCR

Fillimisht si shtylla kryesore në strukturën e UNMIK-ut UNMIK-u ka qenë përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm procesit të kthimit dhe shpërndarjes së ndihmave. Në verë 2001, "Policia dhe Ligji" e zëvendësuan Shtyllën Humanitare dhe UNHCR u nda nga struktur e UNMIK-ut. Ata ani e përshkrujnë rolin e vet si mbikqyrje të proceseve të kthimit për të siguruar aplikimin e parimeve ndërkombëtare nëpër tërë Kosovën., dhe i mbrojnë të drejtat e të zhvendosurve. ¹⁵¹ Ata kanë një përfaqësim të dukshëm në rrjetin e zyrave dhe personelit rajonal.

Edhe pse UNHCR ka marrur pjesë në planifikimin dhe zbatimin e Projektit për Luginën e Osojanit, të cekur më poshtë, organizata ka qenë kundër politizimit të tepërt të projektit dhe kushteve të rnda ekonomike dhe të sigurisë së minoritarëve. Njëherë kanë qenë shumë afër ndërprerjes së plotë të projektit. ¹⁵² Një kthim i tillë i organizuar binte ndesh me parimet e mandatit të UNCR-së - nuk ishte kthim i sigurtë dhe dinjitoz. Pakënaqësia e UNHCR-së lidhur me procesin e kthimeve vazhdon në disa rajone.

UNHCR merr pjesë në Veprimtaritë Punuese të Kthimeve si dhe me grupet punuese rajonale dhe komunale. Ka zyra në cdo rajon të ngarkuara me këshillimin e UNMIK-ut për kthimet, mbikqyrjen e procesit të kthimit, përgjigjjes së kërkesave të të kthyerve spontanë dhe mbështeten e përgjithshme të të drejtave dhe nevojave të të kthyerve. Përderisa UNHCR-ja ka lujatur rol të rëndësishëm në disa rajone në udhëheqjen e procesit të kthimit dhe sigurimin e respektimit të parimeve të riatdhesimit, ajo ka pasur më pak sukses në disa rajone tjera.

Në Beograd UNHCR mban lidje me komunitetin e të zhvendosurve dhe është ërgjegjëse për identifikimin dhe kontrollimin e nevojtarëve në projektet e organizuara të kthimit. Mirëpo nuk ka mundësi t'i drejtojë për koordinimin e të kthyerve potencialë nga erbia dhe Mali i Zi. Kjo pamundësi mund të jetë vecanërisht problematike nëse rritet

¹⁴⁹ Projekt Doracaku për Kthime të Qëndrueshme

¹⁵⁰ Zyra për Kthime dhe komunitete, Strategjia për thime të Qëndrueshme për vitin 2003, Koordinimi i Donatorëve, Takimi për Kosovën, Bruksel, 5 nëntor 2002

¹⁵¹ Intervista E ICG-së me Shefin e Misionit të UNHCR-së, nëntor 2002

¹⁵² Intervista e ICG-së me Përfaqësuesin e UNHCR-së, korrik dhe tetor 2002

numri i kthimeve të organizuara gjatë vitit të ardhshëm.

3. KFOR

KFOR-i kalujatur një rol të madh për stabilizimin e minoritetëve dhe prezenca e tyre e rëndë do të jetë me rëndësi për procesin e kthimit. Deklarata e 6 qershorit e Këshillit të Atlantikut Verior ka theksur se gjendja e sigurisë ka ndryshuar dukshëm për reduktimin e trupave në Bosnë dhe Kosovë. Numri i tanishëm i 32 000 trupave do të ketë një zvogelim të konsiderueshëm - disa vlerësime jozyrtare e përmendin shifrën prej 15 000 trupave. Britanezët do të bëjnë reduktimet më të mëdha, me tërheqjen e afër 900 trupave nga 2800 sa ka sot.¹⁵³

KFOR po largohet nga strategjia e pikave të fiksuara, si pjesë e procesit të reduktimit. Për tu siguruar se kjo gjë nuk e rrezikon sigurinë, KFOR-i është duke llogaritur në marrjen e përgjegjësive nga policia e UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës. Nryshimi nga mbrojtja e KFOR-it në mbrojtjen policore të komunitetit do të jetë si sinjal i normalizimit të gjendjes së sigurisë. Por prapë nuk është e qartë zotësia e Shërbimit Policor të Kosovës për marrjen e këtyre përgjegjësive. Ekziston nevoja për koordinimin të afërt në mes policisë dhe KFOR-it në rast të incidenteve të sigurisë dhe për shmangjen e zbrastësirave të sigurisë gjatë zbatimit të "strategjisë mobile" nga ana e KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut.

4. Policia

Pjestarët e Policisë Civile, si dhe pjestarët e KPS-së janë të rëndësishëm për qëndrueshmërinë e procesit të kthimit. Policët janë pjestarë aktive të grupeve vepruese për kthim në nivelin rajonal dhe komunal. Vecanërisht me reduktimin e ushtarëve të KFOR-it policia do të luaj një rol të rëndësishëm për një ambient të sigurt. policia ka marrur përsipër përcjelljen e minoriteteve aty ku është vlerësuar nga KFOR-i dhe policia se ka rreziqe.

Filozofia e "shërbiit policor të komunitetit" që e udhëheq zhvillimin e Shërbimit Policor të Kosovës është shumë funksionale për ta rritur besimin e komuniteteve minoritare dhe të kthyerve në vetë policinë dhe në ambjentin ku jetojnë. Pjestarët e policisë janë stërvitur për identifikimin e çështjeve problematike që janë shkaktarë kryesorë të krimeve dhe për të formuluar plane për zgjidhjen e tyre. Për shembul policia bën përcjelljen dhe transportimin e minoritetëve aty ku është e nevojshme, ndihmojnë në shpërndarjen e ndihmave për familjet nevojtare, lehtësojnë bisedimet mes komuniteteve dhe i strehojnë familjet në qendrat e policisë deri sa të sigurohet strehimi i tyre.¹⁵⁴ Natyra multi-etnike e KPS-së është me rëndësi për suksesin e mbrojtjes në tërë Kosovën - gati 15% të pjestarëve të policisë janë minoritarë.

5. Qendra për Koordinim për Kosovë dhe Metohi (CCK):

Kjo qendër është entitet i përbashkët i Serbisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë nën udhëheqjen e Zëvendëskryeministrit Nebojsa Covic. Qendra mbështet kthimin masiv sa më shpejtë që është e mundur në lokalitetet e përcaktuara.¹⁵⁵ Skeptikët janë të brengosur se kthimet e tilla masive përmbushin qëllimet politike për ndarjen apo kantonizimin e Kosovës.¹⁵⁶

Në prill qendra ka lëshuar planin e kthimit, 'Parimet e Programi të Kthimit të të zhvendosurve të Brendshëm'. Ky program përqendrohet në pamundësinë e projektit të Osojanit për kthim për vendosjen e ambientit të sigurt për të kthyerit. Për të ofruar një siguri të tillë, Qendra konsideron se enklavat e tanishme duhet të zëvendësohen me grupet e organizuara të banimit. Ata i kanë identifikuar 24 grupe të tilla. Lokalitetet janë zgjedhur për shkaqe sigurie, për mundësinë e lëvizjes, mundësinë e mbrojtjes së traditës kulturore dhe lehtësisë së identifikimit dhe zbatimit të të drejtave mbi token dhe pronën. CCK CCK konsideron se me keto lokalitete do të jetë më e lehtë sigurimi i të drejtave të njeriut, siguria, liria e

¹⁵³ Agence France-Presse, "Britania do të tërheqë 2000 trupa nga Ballkani," 20 shtator 2002

¹⁵⁴ Policia e UNMIK-ut, Policia në Kosovë 2001. Gjetet në www.unmikonline.org/civpol

¹⁵⁵ Intervista e ICG-së me Nenad Radosavljeviq, korrik 2002

¹⁵⁶ Intervista e ICG-së me Sonja Biserko, Komisioni i Helsinkit, tetor 2002

lëvizjes, përkujdesi mjeksor, arsimimi dhe punësimi.

UNMIK-u e ka refuzuar planin e CCK-së për arsye se nuk është dinjitoz dhe i qëndrueshëm. Interesat strategjike të CCK-së janë marrur parasyshtë në këtë plan në vend të dëshirave të të kthyerve. Për më tepër, plani nuk i zëvendëson enklavat për arsye se nuk i adreson kushtet e sigurinsë për ekzistencën e tyre.¹⁵⁷

Roli i CCK-së për lehtësimin e procesit të kthimit nuk ka qënë cdo herë pozitiv. Në një fshat të kthyer në Kamenicë, EAR ka ndihmuar rindërtimin për thimin e familjeve shqiptare dhe serbe. Mirëpo rindërtimi nuk është përfunduar dhe pas disa muajsh, CCK ka insistuar ti përfundojë këto shtëpi për serbët. UNMIK-u dhe UNHCR i kanë bërë trysni CCK-së për ti përfshirë shtëpitë brenda komunitetit shqiptar, PSSP Shtajner ia ka dërguar një letër Z.Coviq duke bërë trysni për këtë ceshtje. Edhe pse CCK-ja përfundimisht është pajtuar, disa pjestrë shqiptarë kanë refuzuar ta pranojnë këtë ndihmë.¹⁵⁸

CCK-ja me cdo kusht i mban strukturat paralele, duke ndikuar në mundësinë e UNMIK-ut për kryerjen e shërbimeve ndj komuniteteve minoritare. Një serb i zhgënjyer i ka thenë ICG-së se "CCK e ka bërë vetëm një të dhetën e asaj që e ka premtuar. Cdo gjë është e lidhur me lojën e Coviqit në Beograd. Ata duan të shaktojnë kaos në vend të bashkëpunimit."¹⁵⁹

Sidoqofte, bashkësisë ndërkomnëtare i nevojitet ndihma nga Beogradi - vecanërisht nga CCK-ja - për t lehtësuar shtrirjen e autoritetit të UNMIK-ut në zonat serbe, vecanërisht në Mitrovicën veriore dhe për të ndihmuar në proesin e kthimit. Përderisa është e qartë se kordinimi i procesit të kthimit në Serbi kërkon përmirësime për shkak të rolit politik të CCK-së, komuniteti shqiptar e shikon si të dyshimshëm iniciativat e sajë të kthimit.

6. Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (PISG)

Përfshirja e Istitucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes është me rëndësi për procesin e kthimit, vecanërisht për shtyrjen e komunave që ta mbështesin kthimin. Por një drejtim i tillë ka qënë me pengesa dhe është kufizuar me veprat e kryeministrit Rexhepi. Në maj, kryeministri Rexhepi e ka vizituar Luginën e Osojanit, dhe më 18 shtator e ka vizituar kampin e Plemetinit - zonë në Obiliq e banuar kryesisht me romë.

Kryetari Rugova, që është kryetar i të gjitha komuniteteve në Kosovë, nuk është kycur në çështjen e kthimit. Me gjithë dominimin e LDK-së në nivelin qendror dhe komunal, dhe me gjithë autoritetin moral tek shqiptarët, deklaratat dhe gjestet e ngjashme me ato të kryeministrit Rexhepi do të ndihmonin t'i bindin njerëzit dhe politikaët në pranimin e kthimit.

Qeveria k ndërmarrur edhe gjeste tjera simbolike. Më 28 qershor, me angazhimin e Dr. rexhepit, Asociacioni i Asamblesë Komunale të Kosovës ka aprovuar Stratgjine e Parimeve të Përbashkëta duke e njohur të drejtën për tu kthyer. Kjo strategji është përmendur shpesh të ketë ndryshuar atmosferën në disa komuna ndaj procesit të kthimit. Dhe më 4 korrik, Asambleja e Kosovës e ka aprovuar rezolutën që mbështetë të drejtën e personav të kthehen në shtëpitë e tyre.

UNMIK-u është përpjekur ta institucionalizojë çështjen e kthimit dhe komuniteteve në nivelin e lartë qeveritar. Zyra e kryeministrit ka Zyrën konsultuese për Komunitete, që punon për tu siguruar se të drejtat e komuniteteve janë të respektura në ligjet e aprovuara.

Mirëpo aktivitetet tjera të dgës legjislative të qeverisë kanë lëshuar sinjale jo edhe aq pozitive për komunitetin serb. Më 14 nëntor, është shtyrë nominimi i gjyqtarëve serbë në gjyqësinë kosovare, masë kritike për krijimin e gjyqësisë shumë-etnike. Në votimin e ligjit për arsim në qershor, kuvendi e ka refuzuar pranimin e universitetit serb në Mitrovicë. Këto aktivitete i dërgojnë sinjale komuniteteve minoritare se të drejtat e tyre nuk pranohen automatikisht dhe nuk janë të mbrojtura nga procesi demokrtati. Për më tepër dyshojnë se

¹⁵⁷ Intervista e ICG-së me Peggy Hicks, Kryesuese e ORC-së, nëntor 2002

¹⁵⁸ Intervista e ICG-së me Zyrën e UNHCR-së në Terren, tetor 2002

¹⁵⁹ Intervista e ICG-së me përfaqësuesin serb, tetor 2002

mos rezoluta e miratuar mbi kthimin nga Kuvendi është gjest bosh.

7. Partitë Politike Shqiptare

Të tri partitë e mbështesin publikisht kthimin, por kjo mbështetje është e bazuar në vetëdijen se një gjë e tillë do të kontribojë për imazhin e Kosovës para bisedimeve të statusit final, më shumë se në vetë dëshirën që ti shohin serbët duke u kthyer. Të tri partitë kryesore e përrahin vetëm kthimin në vendet e prejardhjes, dhe nuk e përkrahin kthimin e personave që kanë marrur pjesë në Armatën Jugosllave, sigurimin serb dhe forcat paramilitare. Ata e kudërshtojnë krijimin e vendbanimeve të reja dhe e interpretojnë angazhimin e CCK-së në proceset e kthimit si ndërhyrje nga Serbia.

8. Partitë Politike Serbe në Kosovë

Cështja e kthimit është e një rëndësie shumë të madhe për lidhshimin politik serb në Kosovë, sic vërehet nga vetë emri i subjektit kryesor politik në Kosovë - Koalicioni Povratak, ose "Kthimi". Cështja e kthimit ka qenë në qendër të bisedimeve me UNMIK-un mbi pjesëmarrjen në institucionet e krahinës. Dokumenti i përbashkët që e ka siguruar pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet në krahinë të nëntorit 2001, e ka theksuar cështjen e kthimit dhe e ka themeluar Zyrën për Kthim dhe Komunitete.

Para se të pajtohet të marri pjesë në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, Koalicioni i Kthimit i ka kërkuar dy pozita të larta në qeveri që kanë për qëllim kthimin.

Përfaqësuesit serbë thonë se nëse nuk arrihet avansimi i kthimeve, popullata serbe në Kosovë do të radikalizohet dhe do të dobësohet pozita e moderuar.¹⁶⁰ Në gjiron e parë dhe të dytë të zgjedhjeve presidenciale në Serbi, më shumë se 60 % e serbëve të Kosovës kanë votuar për kandidatin presidencial të Partisë Radikale (SRS), Vojislav Sheshel.

Partitë politike serbe duhet ta marrin një pjesë të përgjegjësisë së kthimit. Koalicioni i Kthimit mund të ndryshojë atmosferën e kthimeve duke marrur

pjesë në institucionet e PISGG-ut, duke mbështetur strukturat e shërbimeve publike të UNMIK-ut në zonat minoritare dhe duke e bindur opullatën serbe se institucionet e Kosovës janë të tyre.¹⁶¹ Në vendse të bashkëpunojë me UNMIK-un ose PISG-un për përmirësimin e ushteve të komuniteteve serbe, Koalicioni i kthimit është me mbështetjen e sistemit paralel. Dështimi i tyre për të kryer detyrën e udhëheqjes e ka shtyrë komunitetin serb ti kthej sytë drejt Beogradit.¹⁶² Dalja e dobët në zgjedhjet e paradokohshme lokale dëshmon se serbët nuk e ndijnë veten të lidhur me institucionet e Kosovës, dhe i drejtohen udhëheqësve të Beogradit e jo atyre të Kosovës për drejtim.

B. STRATEGJIA E UNMIK-UT PËR KTHIM

1. Strukturat Koordinuese dhe Finansimi

ORC ia ka praqitur më 5 nëntor në Bruksel takimit të Koordinimit të Donatorëve strategjinë për procesin e kthimit. Kjo strategji është zhvilluar për ti plotësuar tri kërkesat për ambient të sigurt, qasje në vende të punës dhe shërbimet publike, dhe rindërtimin dhe ripronësimin e shtëpive.

Për të shmangur përsëritjen e gabimeve të kaluara - disa prej të cilave janë përmendur më lartë - ORC është në procesin e ristrukturimit të metodës së trajtimit të kthimeve nga UNMIK-u. Ata kanë hzrtuar një doracak përkthime të qëndrueshme për të ofruar një udhëzim të shkallëshkallshëm të proceseve të kthimit. Për më tepër ata i kanë shtërnguar mekanizmat koordinues që të ofrojnë mbikqyrje më të madhe qëndrore të procesit të kthimit.

Grupet Punuese të Nivelit Komunal. Këto janë pasardhësit e grupeve punuese të UNHCR-së dhe janë trupat kryesorë koordinues për kthime. Tash e kryesuar nga UNMIK-u, grupet e nivelit komunal shërbejnë si forum i koordinimit lokal të projekteve të kthimit pasi që ipërfshinë autoritete lokale komunale, UNHCR-në, KFOR-in, përfaqësuesit e IDP-s, përfaqësuesit lokal të komuniteteve dhe

¹⁶⁰ Intervista e ICG-së me Milorad Todorović, nëntor 2002

¹⁶¹ Intervista e ICG-së me Departamentin për Demokratizim të OSBE-së, tetor 2002

¹⁶² Intervista e ICG-së me Zyrtar nga UNMIK-u, nëntor 2002

OJQ-të. Ata shërbejnë si forum për angazhimin e komuniteteve të ndryshme në bashkëbisedimet mbi qështjen e kthimit.

Dokumentet e koncepteve të kthimit rishqyrtohen nga Grupet Punuese Komunale. Grupi është mekanizmi kryesorë nëpërmjet të cilit personat e zhvendosur mund të qasen procesit të kthimit dhe mund të kërkojnë ndihmë për t'u kthyer. Mirëpo, dobia e tyre për të zhvendosurit nuk është e sigurt pasi që është vështirë për individëd që banojnë në Sërbi dhe Mal të Zi, t'i qasen takimeve të ëtyre grupeve në Kosovë.

Grupet Punuese Regjionale. Këto grupe veprojnë në pesë rajonet e Kosovës, dhe i mbikqyrin grupet komunale të punës, si dhe i rishqyrtojnë projektet e miratara nga niveli lokal. UNMIK-u, UNHCR-ja, Policia e UNMIK-ut, KFOR-i, OSBE-ja dhe UE-ja të gjithë marrin pjesë në këto grupe. Grupet rajonale i rishqyrtojnë dhe i klasifikojnë dokumentat e koncepteve nga komunitat.

Grupet e Koordinimit të Kthimeve. Grupi i nivelit qendrorë është një trup operacional që i adresonë qështjet e impelmentimit gjatë procesit të kthimit. "Bordi Konsultues Teknik" i përbërë nga ekspertët e kthimit, e përkrah grupin e koordinimit. Ky grup i rishqyrton dokumentat e konceptit nga rajoni, dhe i përgadit listat e projekteve prioritare për tërë Kosovën. Bordi teknik ndihmon në procesin e këtij rishqyrtimi. Pas rishqyrtimit të projekteve kërkonë donatorët, dhe ky grup i rishqyrton projekt propozimet e OJQ-ve bërë donatorëve.

Trupat mbi detyrat e kthimit. Ky grup i mbikshyr proceset e kthimit, ofron koordinim të nivelit të lartë dhe mbështetje policore për kthimet dhe e siguronë implementimin konsistent të politikave të kthimit nëpër gjithë Kosovën. Drejtohet nga PSSP dhe përfshinë Kryeministrin, zyrtarët tjerë të PISG-ut si dhe zyrtarët e lartë nga UNMIK-u, UNHCR-je, HDP-ja dhe KFOR-i. Edhe pse fillimisht i shpallur në Maj 2002, këto trupa nu janë takuar deri më 1 Nëntor.

Strategjia e ORC-së është e përqendruar në nevojën për mbështetjen e të kthyerve spontan si dhe projekteve të organizuara të kthimit. Për t'i dhënë mbështetje kthimeve spontane UNDP do të themeloh një meknizëm fleksibi të donacioneve ku

